# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7533 E shtunë 19 Maj 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)









**Opinioni i Ditës**

Nga RAIMONDA SHUNDI (DERVISHI)

## Seks i dobët apo i fortë?



William Golding (çmimi nobel për letërsinë) - "Mendoj se femrat e kanë çmenduri kur gjykojnë se janë njësoj me burrat. Ato janë shumë herë më superiore ...

Vijon në faqen 21

**Dje në "Europa e lirë"**

Nga ARTON KONUSHEVCI

## Kacafytjet dhe fyerjet mes deputetëve dëmtojnë imazhin e Kuvendit



Degradimi i fjalorit të deputetëve në Kuvendin e Kosovës po thyen të gjitha rregullat e paraqitjes publike, si dhe ligjet në fuqi - thonë përfaqësues të ...

Vijon në faqen 22



Kryeministri: Opozita, sabotim përpjekjeve për negociatat

# Basha, thirrje shqiptarëve: Më 26 maj ta rrëzojmë Ramën. Dëshmia 6-orëshe e dëshmitarit Veliu

Merret në mbrojtje 'dëshmitari X'. Autenciteti i audios, kampion zëri për krahasim

VALENTINA MADANI

Të shtunën e 26 majit në orën 12:00 opozita e bashkuar do të protestojë në shesh para kryeministrisë për të kërkuar largimin e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Vendimi u mor pas takimit të kreut të PD-së, Lulzim Basha ...

Në faqet 2-5

MINISTRI AHMETAJ FIRMOS UDHEZIMIN PER DETYRIMET TATIMORE TE BIZNESIT

# LOJERAT E FATIT, FORMATI I RI PER TATIMIN E TYRE

Miratohet formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit. Nga kazinotë e mëdha te lojërat 'kuqezi', sa duhet të paguajnë pronarët e mëdhenj



*(Në foto)* Lojëra fati (foto ilustruese)

Në faqen 6

**FORMULARI-TIP**

## Pronarët në Fier, ATP merr në shqyrtim 1030 dosje, lista e parë me përfituesit në qark

Në faqet 19-20

**"ME NDAU ME GRUAN"**

## Terror në gjykatën greke: Shqiptari tenton të vrasë personazhin e famshëm

Në faqen 7

**DESHMI NJEREZORE**

## Diana Omari: Përkthimet e Selfos, nën presionin e vdekjes. Kostumi borxh për Enverin në dasmë

Në faqen 11

**UDHEZIMI I MASR**

## Vendimi, ja sa duhet mesatarja për t'u pranuar në universitet, detajet për çdo degë

Në faqen 10

**ME SHUME ZGJEDHJE PER MATURANTET E 2018-ës**




## Universiteti "Luarasi", MASR i jep licencën për Fakultet Teknologjie, Informacioni e Inovacioni

Në faqen 12

BLUE TOOTH

Nga Aurela Gaçe tek Orinda Huta, ja figurat e njohura që kanë pasion të dytë sportet

# Fjorentina Halili e "BB 9": Pse u ndava me Olsin

*Era Istrefi, zë zyrtar i 'Botërorit 2018'. Dhurata e milionerit për Tahirin*

Nga PAMELA ALIAJ

Prej më tepër se një vit jeni jashtë shtëpisë së "Big Brother". Me çfarë merret tani Fjori?Akoma punoj në "Top Channel". Pas pune mundohem të merrem me veten, me familjen dhe nipin tim që e



kam gjënë më të shtrenjtë në botë, në fund vjen dhe shoqëria, siç mund ta keni parë dhe vetë jetën e natës që unë bëj me ta. (qesh) A është dikush në jetën e Fjorit? A ju ka propozuar ende? Të them të drejtën, ka shumë që më shkruajnë ...

Suplement

# ÇESHTJA "XHAFAJ'

## OPOZITA

Si ra në kontakt me Agron Xhafajn, plani për të trafikuar hashash dhe arsyet e dështimit

# Albert Veliu merret në mbrojtje, çfarë dëshmoi 6 orë te Krimet e Rënda

## Autenciteti i audios, kampion zëri për krahasim



Një nga protestat e opozitës

Valentina Madani

Albert Veliu, i identifikuar si "bashkëpunëtori X" në audio-përgjimin e publikuar nga Partia Demokratike, për afro 6 orë me radhë dëshmoi dje në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Fillimisht ai u pa në selinë e Partisë Demokratike, ku u takua me sekretarin për çështjet ligjore, Ivi Kaso dhe deputetin Ervin Salianji, më pas i shoqëruar nga avokatët Artan Murrizi dhe Ivi Kaso iu drejtua organit të akuzës. Mësohet se 'dëshmitari x', tashmë i identifikuar me emrin Albert Veliu është marrë në mbrojtje. Dje dëshmitari shoqërohej nga një grup personash që e ruanin. Ai u paraqit në prokurori rreth orës 11:00 dhe doli nga prokuroria në orën 16:00. Personi që njihet si "bashkëpunëtori X" u mor në pyetje nga prokurori Genci Qana. Veliu është një nder persona kyç në çështjen e audio-përgjimit. Mësohet se për të vërtetuar autencitetin e video-përgjimit, Veliut i janë marrë kampion zëri për krahasim. Gjithashtu, mësohet të jetë pyetur se si ra në kontakt me Agron Xhafajn, si u bë plani për të trafikuar hashash dhe pse ky plan nuk u realizua. Albert Veliu pranoi se kishte folur me Agron Xhafajn për të trafikuar hashash, në videon e shfaqur nga PD-ja. Pas publikimit të intervistës së tij nga selia e PD-së, ai u shoqërua nga Policia e Tiranës, pasi e gjeti atë në banesën e një të njohuri të tij dhe më pas e ka shoqëruar në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Organi i akuzës ka nisur hetimet pas padisë penale të Agron Xhafajt, për kallëzim të rremë ndaj Albert Veliut. Gjithashtu, Prokuroria e Krimeve të Rënda pritet të marrë edhe dëshmitë e personave të tjerë, siç është ajo e personit që ka intervistuar "bashkëpunëtorin X" Albert Veliu, i cili thuhet se është gazetari Jetmir Olldashi. Partia Demokratike u kujdes ta shmangte emrin dhe fytyrën e tij gjatë transmetimit të intervistës me Albert Veliun, por në një prononcim për "Top Channel", gazetari nuk e mohoi se ishte ai autori i intervistës. Pak ditë më parë, vëllai i ministrit të Brendshëm, Agron Xhafaj, depozitoi në organin e akuzës padinë pas audio-përgjimit të publikuar ku pretendon se aty nuk është zëri i tij. Veliu bëri të ditur identitetin e tij, teksa tha se i është kërcënuar familja pas audio-përgjimit dhe se ai është i vërtetë, pasi ajo bisedë me Agron Xhafaj është bërë. Por sipas tij, nuk është ai autor i përgjimit. Albert Veliu është personi i cili në audio-përgjimin e publikuar nga PD flet me Agron Xhafajn për pazare droge. "Bashkëpunëtori X" është marrë në pyetje nga prokurori Genci Qana dhe mësohet se ka konfirmuar në prokurori atë që ka deklaruar në videon e publikuar ditën e djeshme. Prokurori Genci Qana po heton kallëzimin e Agron Xhafajt ndaj deputeteve të PD për audio-përgjimin.



Dëshmitari Albert Veliu

**DESHMIA**

Prokuroria për të vërtetuar autencitetin e video-përgjimit Veliut ka marrë kampion zëri për krahasim. Gjithashtu, mësohet të jetë pyetur se si ra në kontakt me Agron Xhafajn, si u bë plani për të trafikuar hashash dhe pse ky plan nuk u realizua. Albert Veliu pranoi se kishte folur me Agron Xhafajn për të trafikuar hashash në videon e shfaqur nga PD-ja.

**MBROJTJA**

Albert Veliu dje fillimisht u pa në selinë e PD-së, ku takoi sekretarin për çështjet ligjore, Ivi Kaso dhe deputetin Salianji, më pas i shoqëruar nga avokatët Artan Murrizi dhe Ivi Kaso iu drejtua organit të akuzës. Mësohet se "dëshmitari x", tashmë i identifikuar me emrin Albert Veliu është marrë në mbrojtje, ndërkohë që dje shoqërohej nga një grup personash që e ruanin.

### Salianji, Alibeaj e Bardhi merren në pyetje

## Zyrtarët e PD-së, të hënën në prokurori për audio-përgjimin e Agron Xhafajt



Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur të thërrasë ditën e hënë tre zyrtarët e PD, që publikuan audio-përgjimin për Fatmir Xhafajn, vëllain e ministrit të Brendshëm, Agron Xhafajn, me pretendimin se aty dëgjohet zëri i tij teksa flet me "bashkëpunëtorin X" për pazare droge. Në orën 10:00 të së hënës, në 21 maj 2018, është caktuar pikërisht nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për paraqitjen e tre zyrtarëve të Partisë Demokratike, të cilët publikuan video-përgjimin mes "bashkëpunëtorit X" dhe Agron Xhafajt. Deputetët Enkelejd Alibeaj dhe Ervin Salianji si dhe këshilltari ligjor i PD-së, Gazmend Bardhi do të pyeten lidhur me këtë audio-përgjim. Prokuroria i kishte thirrur të enjten zyrtarët demokratë, por për shkak të angazhimeve të tyre me seancën plenare, orari u shty. Shkresa e prokurorisë që specifikon ditën e hënë të 21 majit në orën 10:00 ka mbërritur në selinë e PD dhe kërkon të paraqiten pranë organit të akuzës të zyrtarëve të PD. Ata do të pyeten nga prokurorët P. Kulluri G.Osmanaj. Të martën, (15 maj) oficerët e policisë gjyqësore morën audio-përgjimin e publikuar dhe kanë nisur hetimet për verifikimin e saj. Në audio-përgjim PD pretendon se vëllai i Fatmir Xhafajt, Agron Xhafaj, bën pazare me një person tjetër për trafikun e drogës. Vetë Agron Xhafaj në një letër të hapur për publikun bëri të ditur se do t'u dorëzohet vetë autoriteteve italiane, ndërsa tha se audio-përgjimi është fals për të shantazhuar atë dhe vëllain e tij, Fatmir Xhafajn.



## Manjani, Ramës: Na damkose, ai Alberti është "flamuri i opozitës"

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani reagoi ashpër pas deklaratës së parë që dha kryeministri lidhur me dëshminë me zë e figurë të dhënë nga Albert Veliu, "dëshmitari X", ku nuk kurseu ironinë për opozitën dhe liderin e saj, Basha. Sipas Manjanit, "Ai Alberti është 'flamuri i opozitës', ashtu siç është turpi dhe faqja e zezë e këtij kryeministri faqezi!". "Denoncimi i trafikut të drogës dhe përfshirja e qeverisë në të është pa asnjë dyshim, detyrë e çdo opozite! Deduksionet e logjikës së çekuilibruar të kryeministrit, me demek hokatar, janë shenja e dukshme e kapjes në flagrancë në krim! Po mor po, ai Alberti është 'flamuri i opozitës', ashtu siç është turpi dhe faqja e zezë e këtij kryeministri faqe zi! Për turpin tonë të përbashkët, ky i çekuilibruar na damkosi në Europë si popull trafikant droge dhe si azilant! Jo në BE, por as tek armiqtë e BE nuk nga integron dot ky, që në mënyrë unikale fajëson denoncuesit e së keqes dhe jo të keqen! Bashkëjeton me të gjitha të këqijat e kësaj bote dhe shpall armik çdo njeri që mendon, flet e denoncon lirisht! Gjithmonë ia kanë fajin të tjerët! Thonë se fjala 'pushtet' vjen nga fjala 'pusht'. Sjellja e këtij kryeministri e provon këtë thënie…", shprehet z.Manjani.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Çështja "Xhafaj", opozita e bashkuar thërret shqiptarët në protestë kombëtare

# Basha, thirrje shqiptarëve: Më 26 maj ta rrëzojmë Ramën

## "Ftesa edhe për çdo socialist të ndershëm"

Valentina Madani

Të shtunën e 26 majit në orën 12;00 opozita e bashkuar do të protestojë në shesh para kryeministrisë për të kërkuar largimin e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Vendimi u mor pas takimit të kreut të PD-së Lulzim Basha mesditën e djeshme me aleatët parlamentarë. Ftesën e adresoi nga selia blu kreu i PD-së, Lulzim Basha, përkrah aleatëve të tij me të cilët më herët patën një takim. Basha tha se nuk mund të ketë negociata me një qeveri të lidhur me krimin dhe drogën. "Opozita e bashkuar i fton të gjithë qytetarët shqiptarë, demokratë e socialistë të bashkohemi në protestën më të madhe kombëtare për të larguar pengesën e vetme për Shqipërinë europiane, qeverinë e lidhur me krimin. Ju ftojmë të protestojmë për largimin nga pushteti dhe çdo hallke shteti të atyre që ndihmojnë kriminelët nga Agron Xhafaj tek Habilajt dhe Balilajt. Ne do t'i themi 'ndal' procesit të zëvendësimit të kriminelëve që i shërbenin Tahirit me atë që i shërbejnë Xhafajt. Të gjithë ne jemi në radhë të parë shqiptarë. Duam një Shqipëri europiane, nuk mund të humbasim më kohën duke u marrë me kriminelin e radhës në politikë. Duhet të mbyllim njëherë e mirë kapitullin e krimit në politikë. Nuk hapen negociatat pa luftuar krimin dhe politikanët e lidhur me krimin", theksoi kreu i PD-së. Sipas Bashës, sot duhet të kemi një Ministri të Brendshme dhe një polici që i shërben njerëzve dhe jo një polici që rrëmben natën qytetarë të pafajshëm. "Sot Edi Rama po mbron Fatmir Xhafajn, por ne do ta largojmë atë dhe kupolën mafioze me Edi Ramën në krye",- theksoi z.Lulzim Basha. Basha tha se është momenti për të reaguar dhe për të mos lejuar që fati i vendit të jetë në "duart e kriminelëve". Basha u bëri thirrje qytetarëve të bashkohen për një drejtësi pa lidhje me krimin dhe të barabartë për të gjithë. Në këtë rast nuk bëjnë përjashtim as socialistët e ndershëm. "I ftojmë të gjithë qytetarët të bashkohen në protestën kombëtare për t'i thënë ndal qeverisë së lidhur me krimin. Së bashku mund ta arrijmë. Rama e mbrojti, por ne e larguam Armando Prengën, e mbrojti, por ne e larguam Arben Ndokun, Mark Frrokun, Elvis Rroshin, Saimir Tahirin. Sot po mbron Xhafajt, por në do ta largojmë atë bashkë me qeverinë e tij. Edhe PS ka njerëz të ndershëm që mund t'i shërbejnë popullit, ndaj ju ftoj në protestë edhe ju socialiste të ndershëm. Rama për 4 vjet luftoi popullin dhe ju dha pushtet kriminelëve. T'i themi bashkë 'stop'",- tha Basha. Në këtë 18 maj kundërshtarit të tij politik me të cilin një vit më parë shtrëngoi duart i kujtoi se opozita nuk mund ta lejojë të qëndrojë në pushtet me një qeveri të lidhur me krimin dhe një ministër, vëllai i të cilit është i dënuar për trafik droge. "Qëndrimi i Fatmir Xhafajt si ministër i Brendshëm është kosto për Shqipërinë, është goditje për drejtësinë. Shqipëria ka njerëz të ndershëm që mund t'i shërbejnë popullit. Ne duam një polici ku vetingu të fillojë nga ministri i Brendshëm tek polici më i thjeshtë", tha z.Basha. I bindur është në fitoren edhe të kësaj beteje, teksa Edi Ramës i numëroi të inkriminuarit e prekur nga ligji i dekriminalizimit në radhët e socialistëve. Ky qëndrim i partive aleate vjen një ditë pas dëshmisë së dëshmitarit X, Albert Veliu, i cili pohoi përfshirjen e të vëllait të ministrit të Brendshëm në trafikun e lëndëve narkotike dhe autenticitetin e audio-përgjimit të publikuar nga Partia Demokratike.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha me aleatët

**PARALAJMËRIMI**

"Opozita e bashkuar, demokratë dhe socialistë, për të larguar pengesën e vetme për qeverinë evropiane të lidhur me krimin. Ju ftojmë të protestojmë për largimin nga pushteti të çdo hallke pushteti të lidhur më kriminelët. I ftoj qytetarët që të protestojmë së bashku për largimin e Fatmir Xhafajt. I ftojmë të protestojmë për largimin nga policia të atyre që ndihmojnë kriminelët si Agron Xhafajn, Habilajt, Balilajt", - tha z.Basha.

### "Më 26 maj, protestë kundër qeverisë"

## "Xhafaj", Paloka: Disa ambasadorë e kanë diskredituar veten

Nënkryetari i PD, Edi Paloka hodhi dje akuza ndaj disa ambasadorëve të akredituar në vendin tonë për qëndrimet e tyre pas publikimit të çështjes së vëllait të Fatmir Xhafaj. Paloka në bindjen e tij qëndrimet e disa ambasadorëve i konsideroi si skandaloze, ndërsa tha se kanë diskredituar veten e tyre. "Unë nuk do doja t'i komentoja, sepse ne kemi zgjedhur të merremi me institucione direkte për shumë arsye. Ka pasur dhe reagime për mua të nivelit skandaloz të ndonjë ambasadoreje, por ne kemi zgjedhur të mos merremi me disa individë që vërtet mbajnë tituj si përfaqësues të atij apo këtij vendi apo si përfaqësues të BE, por që për ne praktikisht e kanë



diskredituar veten me qëndrimet e tyre. Ne i mbajmë lidhjet direkte me institucionet dhe janë institucionet ndërkombëtare qoftë ato që lidhen me integrimin e Shqipërisë, qoftë me qeveritë apo kancelaritë europiane i kanë bërë të qartë pozicionet e tyre. Edhe për drogën dhe Saimir Tahirin nuk e hapte askush gojën, më pas u vunë ata me shpatulla pas murit", tha Paloka për Ora News. Deputeti demokrat u shpreh se nuk ka besim se prokuroria do të bëjë një hetim të drejtë. "E dha urdhrin Rama. Ai tha që unë e verifikova audion dhe këtë qëllim kishte, t'i thoshte prokurorisë ky është qëndrimi, qëndrimin e vendos unë. Qëndrimin tonë për prokuroren ne e kemi deklaruar që ditën e parë, vetëm me një synim të shpëtoja Ramën dhe të inkriminuarit e tij dhe ta përdorte kundër opozitës. E para i tha që nuk ka autenticitet video-përgjimin dhe e dyta dha urdhër arresto opozitën",-deklaroi deputeti i PD-së. Në lidhje me protestën që do të zhvillohet në 26 maj, Paloka tha se qëllimi kryesor është largimi i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj.

## Audio-përgjimi, Ristani ironizon Ramën: E pagoi nga rroga agjencinë

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Arben Ristani ka reaguar pas deklaratës së kryeministrit Edi Rama për agjencinë që mori për të vlerësuar audio-përgjimin e publikuar nga demokratët, ku implikohet Agron Xhafaj.



Përmes një statusi në 'Facebook', Ristani me ironi theksoi se Rama ka paguar nga rroga e vet agjencinë, por nuk e tregon emrin e saj. Mes të tjerash demokrati pohoi se Rama ka filluar të flasë përçart. "Rama me qesharak se kurrë. E ka dërguar audio-regjistrimin në një agjenci te specializuar, duke e paguar nga lekët e rrogës së vet, por nuk pranon të tregojë për publikun, emrin e agjencisë. Ka filluar të flasë ashtu si vizaton, përçart. I rrethuar me trafikant droge dhe hajdutë me çizme, ky i marrë është fatkeqësi e këtij vendi",-deklaroi z.Ristani. Kryeministri Rama në një konferencë me gazetarët dje nuk e tregoi emrin e agjencisë që ka bërë vlerësimin e audio-përgjimit të publikuar nga PD ku imlikohet vëllai i ministrit të brendshëm Fatmir Xhafaj.

## Vasili: Rama i inkriminuar dhe mashtrues, s'thotë dot agjencinë

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili reagoi dje pas deklaratës së kryeministrit Rama, një ditë pas publikimit të rrëfimit të dëshmitarit X. Sipas tij kreu i qeverisë nuk thotë dot agjencinë e cila sipas tij bëri verifikimin e audio-përgjimit të publikuar nga PD dhe që sipas Ramës nuk ishte autentik. Duke e akuzuar kryeministrin si mashtrues, Vasili tha se kreu i qeverisë ka gënjyer qytetarët shqiptarë kur u shpreh se "kishte verifikuar audion e përgjimit të vëllait të ministrit dhe deklaroi se ishte e manipuluar". "Kryeministri i inkriminuar dhe mashtrues, dje "verifikoi" audion, sot s'thotë dot agjencinë. Mashtrues ordiner dhe i inkriminuar, ky është kryeministri. Gënjeu shqiptarët kudo që janë dhe u tha me gojën plot se kish verifikuar audion e përgjimit të vëllait të ministrit dhe deklaroi se ishte e manipuluar",-theksoi z.Vasili.

# ÇESHTJA "XHAFAJ"

## REAGIMET

Ministri i Brendshëm flet për akuzat e PD-së, në krah të ambasadores gjermane

# "Dëshmitari X", Xhafaj: Sajesë dixhitale, unë do bëj detyrën

## Schultz: Lufta kundër krimit të organizuar, prioritet kyç

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj e cilësoi dje "sajesa dixhitale", dëshminë e paraqitur nga i ashtuquajturi "dëshmitari X", Albert Veliu. Një ditë pas kësaj dëshmie, Xhafaj tha: "Përsa i përket asaj që më pyetët për dëshminë e paraqitur dje nga PD, dua t'ju them një gjë, që këtu jemi në vendin e Task Forcës Speciale, kurse atje jemi në vendin e 'sajesave dixhitale'. Për të tjerat, detyra ime është të punoj për prokurori speciale, për polici speciale. Detyra e tyre është të punojnë për 'qytetarin dixhital të sajuar'. Kjo s'është çështja ime, është çështje e tyre. Unë kam zgjedhur këtë rrugë, ata kanë zgjedhur atë rrugë. Për mua është shumë e rëndësishme të bëj detyrën", - u shpreh ai. Ministri ishte nën shoqërinë e ambasadores gjermane në vendin tonë, Suzanne Schultz, me të cilën vizituan ambientet e Task Forcës Speciale. Sa për rastin e Arbër Çekajt dhe ngarkesës prej 1,8 ton të kapur së fundmi në Gjemani, ministri tha se shqiptarët nuk janë ndër më problematikët atje, por renditen në vendin e 15. "Për sa i përket çështjes së parë, më duhet të them se shqiptarët nuk janë, nga pikëpamja e statistikave që ne disponojmë nga kolegët tanë, ndër vendet që zënë, që kanë një peshë të rëndësishme në krimin e zhvilluar në territorin gjerman nga të huajt. Dhe sa për dijeninë tuaj, përjashto ato vepra penale që lidhen me kalimin e paligjshëm apo emigracionin e paligjshëm, për pjesën tjetër ndër të huajt, shqiptarët renditen në vendin e 15-të në Gjermani", u shpreh ministri. "Por kjo nuk do të thotë që nuk ka probleme, përkundrazi, ka jo pak probleme që lidhen në fushën e trafikut të drogës, në fushën e trafikut të qenieve njerëzore, në fushën e vjedhjeve të banesave apo mjeteve motorike, të cilat siç thashë, janë çështje që ne i trajtojmë bashkërisht me kolegët tanë gjermanë, në kuadrin e operacionit 'Forca e Ligjit' përmes Task Forcës dhe në kuadrin e njësisë 'Anti-Skifter' të ngritur për hetime të përbashkëta me palën gjermane, përfshi edhe çështjet, të cilat ju sapo i përmendët", - shtoi ai. Xhafaj vlerësoi bashkëpunimin me autoritetet gjermane si në këtë rast, ashtu edhe për të çuar përpara 'Task Forcën Anti-Skifter'. "Ne kemi disa çështje, Task Forca në proces hetimi policor të përbashkët me autoritetet policore gjermane. Janë çështje shumë të ndjeshme edhe për publikun shqiptar. Pala gjermane, homologët tanë, kolegët e Policisë gjermane janë duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, jo thjesht asistence, por edhe shkëmbim informacioni, hetim të përbashkët, për të pasur sukses në hetimin e këtyre çështjeve të rëndësishme për publikun shqiptar dhe jo vetëm për publikun shqiptar. Unë e vlerësoj shumë prezencën e ambasadores edhe për mesazhet që ajo përcolli në mbështetje të Task Forcës edhe për mesazhet e qeverisë së saj për forcimin e luftës kundër krimit të organizuar", tha Xhafaj. Ambasadorja Susanne Schuetz në qëndrimin e saj theksoi se lufta ndaj krimit të organizuar është një prioritet kryesor për anëtarësimin në BE. "Kemi nisur punën, kemi arritur rezultatet e para e do vazhdojmë ta mbështesim. Dua të theksoj se lufta kundër krimit të organizuar është prioritet kyç për integrimin në BE dhe ne do të vazhdojmë të mbështesim në këtë drejtim", tha ambasadorja gjermane.



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

### Basha-Lu, së bashku në dekorimin e Michael D. Granoff




Kreu i Partisë Demokratike është shfaqur dje në një aktivitet në krah të ambasadorit amerikan, Donald Lu. Kjo është fotoja e parë në një takim mes Bashës dhe Lu-së, pas denoncimeve të fundit nga opozita. Fotoja është bërë gjatë një aktiviteti gjatë dekorimit të drejtori të Bordit të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit, Michael D. Granoff.



Grupi parlamentar i PS-së

**PJERIN NDREU**

Deputeti i PS-së tha dje: "As informatori, as dëshmitari, as denoncuesi që është pijanec, hajdut, drogaxhi, mashtrues nuk është marrë seriozisht asnjëherë as në atë kohë të diktaturës, kur duhej të dënohej dikush. Personaliteti i personit që flet diçka është baza nga nisesh për ta besuar apo jo! Një njeri që shitet e blihet lirë, nuk mund të besohet e të serviret si zëdhënës i së vërtetës! Kaq poshtë ka rënë politika shqiptare e opozitës", tha Ndreu.

### Trajnohen policët e burgjeve, ministrja: Do u jepet status më i mirë

## Gjonaj: Dënim maksimal për efektivët e burgjeve, që përfshihen në korrupsion

Humbja e vendit të punës për efektivët e burgjeve që tentojnë të bëjnë korrupsion do të jetë gjëja më e vogël që mund t'u ndodhë, ndërsa për këta të fundit do të kërkohet dënim maksimal. Kështu u shpreh ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, gjatë ceremonisë së zhvilluar sot, ku 260 punonjësit e rinj u bënë pjesë e efektivëve të burgjeve. "Toleranca zero për tentativën më të vogël për korrupsion. Humbja e vendit të punës është gjeja me e lehtë që mund të ndodhë nëse tentoni të bëni korrupsion. Dënim maksimal për çdo efektiv që do të tentojë të bëhet pjesë e paligjshmërisë", - tha Gjonaj. "Do të duan t'ju korruptojnë. Do të duan t'ju ofrojnë para, apo përfitime të tjera në shkëmbim të uljes së vigjilencës, apo tolerimit ndaj shkelësve të ligjit", tha ministrja. Gjonaj përmendi edhe planin për rritjen e rrogave për ta dhe për të përmirësuar kushtet e sigurisë. "Ndryshimet synojnë dhënien e një statusi të veçantë më të mirë për punonjësit e policisë së burgjeve si në aspektin financiar, ashtu edhe në rritjen e profesionalizmit të tyre, duke ndryshuar mënyrën e rekrutimit, edhe të trajnimit", tha Gjonaj. Ndërkaq, ajo tha se qeveria është e vendosur të ndryshojë mentalitetin dhe procedurën e rekrutimit të punonjësve të policisë së burgjeve. "Kalimi i testimit është vetëm hapi i parë dhe më i lehti për t'u bërë pjesë e trupës së policisë së burgjeve. Keni përpara një detyrë shumë komplekse dhe shumë të vështirë. Do të nisë me fazën e trajnimit, ashtu si bëtë me fazën e testimit dhe më pas do të vijë pjesa më e vështirë, përballja me terrenin", tha ministrja. 260 efektivët e rinj të burgjeve fituan testimin mes 1400 konkurrentëve të tjerë. Kreu i Akademisë së Sigurisë, Bilbil Mema dhe përfaqësues të misioneve të huaja që asistojnë policinë, siguruan Ministrinë e Drejtësisë se trajnimi për herë të parë i efektivëve të Policisë së Burgjeve nga pedagogët dhe specialistët e Akademisë së Sigurisë është mënyra e duhur për të përgatitur një staf të përkushtuar.



Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj

STRATI

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- Nr. Pasurie Nr. 6/36, Vol. 3, Faqe 137, Zona Kadastrale 1441, Arë me sipërfaqe 2400 m2, me vendndodhje ne Damjan - Tiranë, regjistruar në bashkëpronësi të Z. Ymer Tresa, Zj. Pranvera Tresa, Z. Florenc Tresa, Zj. Laerta Hakcani (Tresa). Çmimi fillestar i ankandit është 2.000.000 Lekë.
Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 23.05.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

STRATI

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-"Apartament", me sipërfaqe 243.30 $m^2$, ndodhur në Fier, me Nr. 4/892+1-2 Pasurie, Zona Kadastrale 8533, volumi 22, faqe 228, rregjistruar në pronësi të Z. Adif Llakaj. Çmimi fillestar i ankandit është 54,880 Euro.
Ankandi për pasurinë e mësipërme zhvillohet në datë 23.05.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

3H

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k**
Adresa: Rr." Demokracia" Pll.1, Kt.1, Vore, Tirane. .
Web: www.3-h.al; Email: shpgj_3h@yahoo.com Tel/Fax +355(0) 44532482

Njofton shpalljen e ankadit nga **dt.17.05.2018 deri ne dt. 25.05.2018** per: sende të luajtshme mjeti me targe AA 957 GX Nissan Atleon 140, Vit prodhimi 2000, karburant-nafte, per skrap ne pronesi te Subjektit "Harizi Co" me Nipt K82122503F

**Çmimi fillestar eshte 78,400.00 (shtatedhjete e tetemije e katerqind) Leke**
**Ankandi zhvillohet ne zyren permbarimore ne daten 25.05.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.**



Kryeministri kthehet nga Sofja: Opozita, sabotim përpjekjeve për të hapur negociatat

# "Xhafaj", Rama: Audio-përgjimi i PD-së, një manipulim i shëmtuar

## "Ministri do të vazhdojë të kryejë detyrën me përgjegjshmëri"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama, i sapokthyer nga samiti i Sofjes e cilësoi "një maskaradë të organizuar" për të penguar hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian, audio-përgjimin e PD-së dhe dëshmitarin X, i cili u shfaq të enjten publikisht. I pyetur nga gazetarët, gjatë një konference organizuar në aeroportin e Rinasit, Rama nuk dha emrin e kompanisë, të cilës ai i ishte drejtuar për të provuar autenticitetin e audios, por tha se ai ishte i bindur se ajo nuk ishte autentike. "Unë nuk i jam drejtuar asnjë firmë dhe as një kompanie, unë i jam drejtuar një agjencie të specializuar. Adresën nuk mund t'ua jap dhe ajo çka kam bërë ka qenë urgjente për mua, për të ditur unë të vërtetën. Nuk ka vlerën e një prove. Provën duhet ta identifikojë dhe ta certifikojë cilado që të jetë ajo, prokuroria, por për sa më takon, jam shumë i qartë. E thashë dhe e përsë-ris, bëhet fjalë për një maska-radë të organizuar me qëllime që janë të qarta për të gjithë dhe e motivuar nga frymëzimi malinj për të bërë çmos për të penguar dhe mundësitë hedhur në erë negociatat për anëtarësim të Shqipërisë",-u shpreh dje, Rama. "Besoj që dita e dje-shme duhet t'ju ketë dhënë të gjithëve mundësinë të shikoni përmes audio vid-eo shpk-së të Partisë Demokratike se në çfarë der-exheje është katandisur Par-tia Demo-kratike, se çfarë mungese të plotë respekti ka Partia Demokratike për in-teligje-ncën e shqiptarëve dhe se pse ka pritur pikërisht këtë kohë për të bërë këtë gjë, për diçka që e ka pasur në dorë më parë. Të gjitha këto, besoj janë të mjaftueshme dhe në një kuptim, unë e falënderoj Partinë Demokratike që e bëri shumë të lehtë demaskimin e këtij maskarade me atë shfaqje që dha dje në skenën e teatrit të SHQUP-it", tha më tej, kryeministri. Sipas tij, "ajo çka i është servirur publikut shqiptar si një material autentik është thjesht dhe vetëm një manipulim i shëmtuar, pastaj detajet, si-të dhe pse-të e këtij manipulimi, janë çështje të prokurorisë dhe patjetër janë edhe çështje të debatit kur diskutojmë pse u bë kjo dhe pse u bë pikërisht në këtë moment". Më tej, ai e cilësoi sabotim monumental atë që po bën opozita ndaj përpjekjeve për hapjen e negociatave. Kryeministri tha se do t'u qëndronte strikt qëndrimeve që ka mbajtur edhe në rastet e mëparshme si të ish-kryetarit të bashkisë së Kavajës, Elvis Roshi, ashtu edhe të ish-ministrit Saimir Tahiri. "Ndërkohë që në rastin konkret po ju them që unë përgjigjen që më duhet për të vendosur nëse është ligjërisht nuk bëhet fjalë, figura e ministrit të Brendshëm, e kam marrë. Ministri i Brendshëm do të vazhdojë të jetë në krye të detyrës të cilën e bën me përgjegjshmëri dhe me rezultate shumë domethënëse, përditë e më domethënëse, të cilat janë një tjetër arsye pse këta janë kaq të shqetësuar për ministrin e brendshëm",-theksoi Rama.

**INTEGRIMI**

Ai tha se ishte kthyer nga Sofja më optimist, pavarësisht se BE ka problemet e saj të brendshme. "Kam shumë besim që edhe në qershor ne nuk do të sprapsemi forcërisht me një vendim që do të jetë pa dritë. Se sido të jetë dhe se në çfarë mënyre ne do të na jepet mundësia që të vazhdojmë përpara në këtë rrugë ku kemi hyrë, kjo është diçka që është për t'u materializuar në fund të qershorit", tha Rama. "Për sa i përket baltës, balta nuk është ajo që përcakton vendimin e Gjermanisë, apo vendimin e Francës apo vendimin e BE, por balta ushqen ata që brenda këtyre vendeve janë në parlamente, janë në zyra dhe janë kundër, jo Shqipërisë, por kundër zgjerimit të BE, dhe që e thashë nuk kanë as kohë, por as dëshirë që kur marrin një lajm nga audio, video, shpk-ja e SHQUP-it të thellohen më shumë, por thjesht siç e marrin e lëshojnë nëpër korridore për të thënë "ja". Pra është si të thuash një pengesë më shumë që Shqipëria nuk e ka merituar dhe s'mund ta meritojë ta hasi në këtë rrugë nga shqiptarët", u shpreh Rama.



Kryeministri Edi Rama

**OPOZITA**

"Balta bën punën e saj në mjegullën në të cilën ndodhet sot BE, në raport me vetveten e lëre më pastaj në raport me Ballkanin ose me ne. Balta bën punën e saj edhe tek njerëzit e zakonshëm që ndjekin jetën politike dhe për këtë unë nuk kam fjalë tjetër. Është fjalë që thjesht tregon atë që po ndodh", - tha dje, Rama.

**DEBATI**

Kryeministri Rama e ka gjetur veten në një pozitë të vështirë ditën e sotme në konferencën e tij nga Rinasi. Pas deklaratës së tij, ai është gjendur në vështirësi nga pyetjet e gazetares së "Fax News", Ambrozia Meta. Pyetjeve për akuzat ndaj Tahirit dhe Xhafajt si të implikuar në trafikun e drogës dhe insistimit të gazetares për përgjigje, Rama i është përgjigjur me kundërakuza për propagandë dhe pastaj është detyruar të lërë konferencën për shtyp.

Tsipras: Bisedimet me Shqipërinë, më të vështira se me Maqedoninë

# Kryeministri grek: Jam optimist, në qershor marrëveshje dhe negociatat për Shqipërinë

Kryeministri i Greqisë Tsipras nga Samiti i Sofjes është shprehur optimist dje për hapjen e negociatave për Shqipërinë në fund të qershorit. Kryeministri grek deklaroi se vendi i tij mbështet fuqishëm perspektivën europiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Në Samitin e BE-së, që do të zhvillohet në fund të qershorit, do të merren vendimet nëse BE-ja do të fillojë negociatat e aderimit me Maqedoninë dhe Shqipërinë",-deklaroi Tsipras, cituar nga IBNA. Ai tha se vendimi nuk varet nga ecuria e bisedimeve për çështjet e vjetra mes dy vendeve, ndërsa shtoi se presin një rezultat pozitiv në qershor. Tsipras tha se "këto janë më të vështira se sa ato mes Greqisë dhe Maqedonisë për çështjen e emrit për shkak të çështjeve që kanë të bëjnë me kufijtë detar dhe të drejtat e minoritetit grek në Shqipëri". Megjithatë, ai theksoi se "negociatat mes Athinës dhe Tiranës për këto çështje të hapura janë të kënaqshme dhe shtoi se është bërë progres i rëndësishëm" "Negocimi ishte i vështirë. Duhej shumë kohë. Ne kemi çështje të hapura që nga Lufta e Dytë Botërore, të drejtat e pakicës greke, etj. Por jemi në rrugën e duhur, jam shumë optimist, mund të kemi një rezultat pozitiv në qershor. Negociatat për Shqipërinë? Përtej kësaj, nëse Shqipëria merr dritën e gjelbër për anëtarësim, ajo nuk varet vetëm nga zgjidhja e dallimeve midis nesh. Ka disa vende që kanë një vlerësim të ndryshëm në këtë drejtim",-tha kryeministri i Greqisë Tsipras.



# Balla: Berisha po shkatërron PD nga frika e rihapjes së dosjes 'Haxhia'

Kryetari i grupit të PS, Taulant Balla deklaron se Sali Berisha kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla deklaroi dje, se Sali Berisha po shkatërron PD, nga frika e rihapjes së dosjes "Haxhia", ndërsa përmend edhe ecurinë e dosjes "CEZ", por edhe dosjen e "financimit rus". Sipas Ballës, që në momentin që Izet Haxhia është arrestuar në Stamboll në vitin 2006, Haxhia ka qenë një problem psikologjik dhe politik për Sali Berishën, dhe ka ngrënë disa koka ministrash Drejtësie të emëruar nga vetë Sali Berisha. "Historia e dosjes "Haxhia" nuk është një problem i ri për Sali Berishën. Qyshkur se Izet Haxhia është arrestuar në Stamboll në vitin 2006, ai ka qenë një problem piskologjik dhe politik për Sali Berishën, dhe ka ngrënë disa koka ministrash Drejtësie të emëruar nga vetë Sali Berisha dhe të shkarkuar për garancitë e dhëna prej tyre për rihapjen e dosjes", shkroi dje, Balla, në "FB". "Gjatë qeverisjes 2005-2009, u shkarkuan 3 ministra të Drejtësisë: Aldo Bumçi, Ilir Rusmajli dhe Enkelejd Alibeaj. Kjo kronologji viktimash të pafajshme të drejtësisë, për shkak të kërkesës së vazhdueshme të tyre, se dosja "Hajdari" do rihapej me ardhjen e Haxhiajt, tregon se Berisha ka qenë në makth nga ministrat e tij, dhe duke mos dashur t'ua ekspozojë makthin e tij, i shkarkonte të gjithë që e bënin", u shpreh Balla. Sipas Ballës, "makthi i tij qëndron tek rihapja e dosjes "Hajdari", të cilën ai nuk e rihapi kurrë, edhe pse e kishte premtim kryesor kur erdhi në pushtet në vitin 2005".

ZYRA PËRMBARIMORE PRIVATE ENIRJETA ZISI

**Permbaruese gjyqesore private Enirjeta Zisi z**hvillon ankandin per shitjen e pasurise se paluajtshme "Apartamenti" me siperfaqe 92.1m2, ZK.3866, Nr.Pasurie.300/143+1-7,Vol.83,Fq.186,Indeksi i Hartes K-34-100, te ndodhur ne Tirane, Yzberisht prane rruges "Joklin Persi ", kati i 3 ,shk.1 ap.7 Tirane,per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Yzeir Llanaj,

Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është ne shumen 4.778.400 (kater miljon e shtateqind e shtatedhjete e tete mije e katerqind) leke. e percaktuar ne vendimin gjyqesor.

**Ankandi zhvillohet ne date 20.04.2018, ora 16.00 ne zyren e Permbarueses gjyqesore private Enirjeta Zisi, Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati "Gora"Kulla.2,Kati i 2, Tirane Nr.Tel. 0694799000, email:enirjeta.zisi@gmail.com**

Miratohet formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit

# Tatimi, baste sportive 25% mbi fitimin nga loja

## *Ahmetaj firmos udhëzimin e ri për detyrimet tatimore*

Ornela Manjani

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar një format të ri të formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit. Udhëzimi është botuar në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi sot. Konkretisht, krahasuar me udhëzimin e vjetër, Ministria e Financave ka vendosur të shtojë një faqe deklarimi në formular, seksioni "C" dhe seksioni C.1,i cili do të plotësohet vetëm nga tatimpaguesit dhe lojërat e fatit të përfshira në Sistemin Qendror të Monitorimit Online (SQMO). Në seksionin C janë shtuar tri kategori, bastet sportive për pikat sekondare të hapura; Kazinotë/Kazino me 5 yje dhe resort kazino (pozicione në tryeza me më shumë se një pozicion, ruletë për çdo pozicion, tryeza të lojërave me letër dhe ose me zare; Makina elektronike në kazino me 5 yje) si dhe kategoria baste gara me pistë ku përfshihen (baste gara në pistë, kuotë fikse për shoqërinë; pika shitjeje në baste gara në pistë (tatim, kuotë fikse për çdo pikë shitjeje; Kompjuterë elektronikë ose pozicione të makinës elektronike në lojërat elektronike me fitim në çast në bastet sportive gara në pistë). Ndërsa në seksionin C1 kanë detyrim ta plotësojnë veprimtaritë me të ardhura më të larta, konkretisht, bingo televizive; baste sportive; lotari kombëtare; lojë elektronike në distancë, kazinotë elektronike me 15% mbi të ardhurat bruto; si dhe shtohet kategoria e kazinove/kazino me 5 yje dhe resort kazino, që për tryezat me më shumë se një pozicion ruletë, kanë 12% mbi vëllimin e qarkullimit. Ndërkohë me hyrjen në fuqi të këtij të udhëzimit të ri shfuqizohet ai i ministrit të Financave nr. 27, datë 25.11.2013, "Për formatin e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit".


FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI LOJËRAT E FATIT

Numri i vendosjes së dokumentit (NVD) (Vetëm për përdorim zyrtar)

[2] Periudha tatimore

[1] Numri Serial:

Numri i identifikimit i personit të tatueshëm (NIPT): [3]
Emri tregtar i personit të tatueshëm: [4]
Emri, mbiemri i personit fizik: [5]
Adresa: [6]
Qyteti/komuna/rrethi:
Numri i telefonit: [7]

[8] Pa veprimtari

SEKSIONI A

| Rubrika | Emërtimi i veprimtarisë së lojës së fatit | Nr. | Detyrimi |
|---|---|---|---|
| I | BINGO PËR PJESËMARRJE BRENDA SALLËS | | |
| [9/10] | Bingo që zhvillohen për pjesëmarrës brenda sallës, në rrethe, të kat. I | [9] | [10] |
| [11/12] | Bingo që zhvillohen për pjesëmarrës brenda sallës, në rrethe, të kat. II | [11] | [12] |
| [13/14] | Bingo që zhvillohen për pjesëmarrës brenda sallës, në rrethe, të kat. III | [13] | [14] |
| II | BASTE SPORTIVE | | |
| [15] | Për 1 deri 99 NIPTE | | [15] |
| [16] | Për 100 deri në 149 NIPTE | | [16] |
| [17] | Mbi 150 NIPTE | | [17] |
| [18/19] | Baste sportive për pikë basti, në rrethe, të kat. I | [18] | [19] |
| | Baste sportive për pikë basti, në rrethe, të kat. II | [20] | [21] |

| Rubrika | Emërtimi i veprimtarisë së lojës së fatit | Qarkullimi/ fitimi | Detyrimi |
|---|---|---|---|
| VI | BINGO TELEVIZIVE | | |
| [53/54] | Bingo që nuk zhvillohen për pjesëmarrës brenda sallës 10% mbi qarkullimin | [53] | [54] |
| [II/1] | BASTE SPORTIVE | | |
| [55] | Baste sportive 25% mbi fitimin nga loja | | [55] |
| [III/1] | KAZINO ELEKTRONIKE | | |
| [56/57] | Për çdo sallë, slot, videolotari, rrethe, të kat. I (4%), mbi qarkullimin | [56] | [57] |
| [58/59] | Për çdo sallë, slot, videolotari, rrethe, të kat. II (4%), mbi qarkullimin | [58] | [59] |
| [60/61] | Për çdo sallë, slot, videolotari, rrethe, të kat. III (4%), mbi qarkullimin | [60] | [61] |
| VII | LOTARI KOMBËTARE | | |
| [62/63] | Lotari kombëtare 10% mbi qarkullimin | [62] | [63] |
| VIII | KAZINO ELEKTRONIKE NË DISTANCË | | |
| [64/65] | Kazino elektronike në distancë 15% mbi qarkullimin | [64] | [65] |
| [IV/1] | KAZINO | | |
| [66/67] | Për tryezat me më shumë se një pozicion, ruletë 12% mbi qarkullimin | [66] | [67] |
| [68/69] | Për tryezat të lojërave me letër dhe ose me zare 12% mbi qarkullimin | [68] | [69] |
| [70/71] | Për lojërat elektronike dhe videolotari në kazino 4% mbi qarkullimin | [70] | [71] |
| [72/73] | Për makinat slot me fitim në çast 4% mbi qarkullimin | [72] | [73] |

*Seksioni "C" dhe seksioni C.1 plotësohet vetëm nga tatimpaguesit dhe lojërat e fatit të përfshira në Sistemin Qendror të Monitorimit Online (SQMO)*

SEKSIONI C

| Rubrika | Emërtimi i veprimtarisë së lojës së fatit | Nr. | Detyrimi |
|---|---|---|---|
| IX | BASTE SPORTIVE | | |
| [74/75] | Pika sekondare të hapura | [74] | [75] |
| X | KAZINO/KAZINO ME 5 YJE/RESORT KAZINO | | |
| [76/77] | Pozicione në tryeza me më shumë se një pozicion, ruletë (për çdo pozicion) | [76] | [77] |
| [78/79] | Tryeza të lojërave me letër dhe ose me zare | [78] | [79] |
| [80/81] | Makina elektronike në kazino me 5 yje | [80] | [81] |

Formulari

### ORGANIZIMI

Organizatori i basteve sportive paguan tatim për lojërat e fatit 25 për qind mbi fitimin nga loja, por jo më pak se:
**a)** për 1 deri në 99 NIPTE, 10 000 000 lekë në muaj, për çdo shoqëri që kryen këtë veprimtari;
**b)** për 100 deri në 149 NIPTE, 12 000 000 lekë në muaj, për çdo shoqëri që kryen këtë veprimtari;
**c)** mbi 150 NIPTE, 14 000 000 lekë në muaj, për çdo shoqëri që kryen këtë veprimtari. Organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë.
Përveç pagesave të shoqërisë, për çdo pikë basti, duhet të kryhen pagesat në tarifa fikse mujore, si më poshtë:
**a)** për rrethet e kategorisë së parë, 40 000 lekë;
**b)** për rrethet e kategorisë së dytë, 30 000 lekë;
**c)** për rrethet e kategorisë së tretë, 20 000 lekë.

### BASTET SPORTIVE

Kuota fikse sipas ligjit në vlerën 10.000.000 lekë.
Nëse rubrika 55 rezulton me e madhe se kjo vlerë, atëherë kjo rubrikë bëhet 0. Nëse rubrika 55 është më e vogël se kjo vlerë, atëherë kjo rubrikë mbetet dhe rubrika 55 bëhet 0.
Kuota fikse sipas ligjit në vlerën 12.000.000 lekë.
Nëse rubrika 55 rezulton me e madhe se kjo vlerë, atëherë kjo rubrikë bëhet 0. Nëse rubrika 55 është më e vogël se kjo vlerë, atëherë kjo rubrikë mbetet dhe rubrika 55 bëhet 0.
Kuota fikse sipas ligjit në vlerën 14.000.000 lekë.
Nëse rubrika 55 rezulton me e madhe se kjo vlerë, atëherë kjo rubrikë bëhet 0. Nëse rubrika 55 është më e vogël se kjo vlerë, atëherë kjo rubrikë mbetet dhe rubrika 55 bëhet 0.
Numri i pikave të bastit në rrethe të kategorisë I.
Kuota fikse për pikë basti në rreth të kategorisë I shumëzuar me numrin e pikave të bastit në rrethe të kategorisë I, rubrika [18] x 40 000 lekë.
Numri i pikave të bastit në rrethe të kategorisë II.
Kuota fikse për pikë basti në rreth të kategorisë II shumëzuar me numrin e pikave të bastit në rrethe të kategorisë II, rubrika [20] x 30 000 lekë.
Numri i pikave të bastit në rrethe të kategorisë III.
Kuota fikse për pikë basti në rreth të kategorisë III shumëzuar me numrin e pikave të bastit në rrethe të kategorisë III, rubrika [22] x 20 000 lekë.

### LIGJI PËR LOJËRAT E FATIT

Bastet sportive deri në 1000 adresa sekondare. Distancat nga njëra pikë basti te tjetra duhet të jetë jo më pak se 100 metra në vijë ajrore. Distancat do të llogariten ndërmjet ekstremiteteve më të afërta të dy objekteve. Mënyra e përllogaritjes së distancave sipas kësaj pike përcaktohet me udhëzim të ministrit të Financave. Në rast se brenda kësaj periudhe shoqëritë nuk kanë ndryshuar vendndodhje, Agjencia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) procedon me masa administrative deri në heqjen e licencës. Ligji i ri, gjithashtu, ndalon nxitjen për të marrë pjesë në lojërat e fatit. Ndalohet ofrimi, ndihma ose nxitja e një loje apo e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë. Organizatorët e lojërave të fatit janë të detyruar të vendosin në mënyrë dalluese në ambientet ku luhen lojëra fati mesazhe në lidhje me luajtjen e lojërave të fatit nga lojtarët në mënyrë të përgjegjshme, rreziqet e mundshme të lojërave të fatit, si dhe shanset reale për të fituar. Gjithashtu, ligji i ri ndalon zhvillimin e aktivitetit të lojërave të fatit pranë institucioneve fetare, institucioneve të arsimit parauniversitar dhe institucioneve të arsimit të lartë.

## Frekuencat e brezit 800 Mhz

# AKEP propozon hapjen e garës për internet të shpejtë



Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i ka dërguar ministrit të Infrastrukturës propozimin zyrtar të hapjes së garës për të dhënë në përdorim frekuencat e brezit 800 Mhz. Bëhet fjalë për frekuencat e liruara nga mbyllja e transmetimeve analoge dhe përdorimi i tyre do të mundësojë zgjerimin e ndjeshëm të spektrit për internetin me brez të gjerë nga rrjetet celulare, sidomos përmes teknologjisë 4G. Procedura e tenderimit pritet të bëhet duke i vlerësuar ofertat me raunde, me qëllim krijimin e mundësive të marrjes së frekuencave në këtë brez të paktën për tre operatorët aktualë të shërbimeve të lëvizshme. Çmimi dysheme për pranimin e ofertave, së bashku me detajet e tjera, do të bëhen publike vetëm pas miratimit të ministrit të linjës dhe hapjes zyrtare të tenderit. Pritshmëritë nga tenderimi i këtij brezi kanë qenë për të ardhura deri në 50 milionë euro, por duke pasur parasysh komentet e operatorëve dhe rënien e ndjeshme të fitimeve në këtë treg, do të jetë shumë e vështirë të sigurimi i një shifre të tillë. Madje, një nga operatorët ka propozuar që këto të drejta të jepen pa pagesë, duke pasur parasysh koston e lartë të investimeve për ngritjen e rrjeteve dhe politikat e qeverisë për rritjen e depërtimit të internetit në zonat rurale dhe periferike. Nuk ka të ngjarë që këto të drejta përdorimi të jepen pa pagesë, megjithatë është e qartë se operatorët nuk janë të gatshëm të paguajnë shuma të mëdha dhe të krahasueshme me tenderët e mëparshëm. AKEP vlerëson se dhënia e brezit 800 Mhz në përdorim për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike do të kete një impakt të ndjeshëm jo vetëm në këtë sektor, por në të gjithë zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë.

## "By pass"-i i Tepelenës

# Fondi 18 milionë euro për ndërtimin, ARRSH hap tenderin



By pass-i i Tepelenës është projekti i radhës që pritet të zbatohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Ky i fundit hapi procedurën e prokurimit këtë të premte duke llogaritur një fond limit për realizimin prej rreth 18 milionë euro. Projekti përfshin lidhjen e segmentit të sapondërtuar Levan-Tepelenë, me segmentin Tepelenë-Gjirokastër-Kakavijë. Projekti parashikon përmirësimin e gjurmës ekzistuese. Rruga fillon ku ndërpritet segmenti Levan-Tepelenë dhe përfundon me piketakimin me segmentin Gjirokastër-Tepelenë. Gjatësia është 2.2 kilometra. Një pjesë e këtij aksi është nën kala me gjatësi 475 metra për të cilën është propozuar që të zgjerohet duke e projektuar këtë zgjerim me një gjysmë urë nga rruga ekzistuese ndërsa pjesa tjetër si një rrugë konvencionale malore. "Rruga është konceptuar si e ndare ne dy segmente dhe tre nyje. Fillon me nyjën 1 zgjatimi i së cilës lidhet me rrugën ekzistuese, pastaj kalon në një zonë poshtë kalasë me urë tip rame deri në fund të shtrirjes së kalasë. Për shkak të shpatit të kalasë rruga në kë të zonë zgjerohet tërësisht nga ana e shpatit. Pas kësaj vazhdon rrugë e zakonshme me dysheme fleksibël deri në sheshin e qendrës, nyjat 2-3-4. Ne këtë zonë kemi zgjerimin e urës ekzistuese hark" thuhet në dokumentet që shoqërojnë procedurën e prokurimit. Afati për paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë të interesuar për këtë projekt është lënë 18 qershori . Kompania që do të plotësojë kushtet dhe do të shpallet fituese nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të ketë 22 muaj kohë për të zbatuar projektin nga momenti që nënshkruhet kontrata

### 30 pjesëtarë të rinj iu shtuan batalionit Komando

# Betohen komandot e rinj, Xhaçka: Trajtim më i mirë për ushtarakët në 2019

Pjesëtarët më të rinj të batalionit Komando, u betuan pas përfundimit të kursit 3-mujor, gjatë së cilit treguan aftësitë e nevojshme fizike dhe psikologjike për të shërbyer në detyra dhe operacione të vështira. Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka uroi ushtarët e rinj për përfundimin e kursit dhe i inkurajoi ata për përgjegjësitë shtesë, me të cilat ngarkohen tashmë. "Dua t'ju përgëzoj të gjithëve për përfundimin e kursit. Jam vërtet shumë e impresionuar me çfarë pashë. Kjo është një njësi elitë e Forcave tona të Armatosura dhe ju jeni bërë pjesë e saj, dhe për këtë pa diskutim që do të keni një përgjegjësi shumë të madhe dhe pritshmëritë që ne kemi për ju janë vërtetë pa kufi, ashtu sikundër janë pa kufi edhe shpresat njerëzore kur jetët janë nën kërcënim. Ajo që ju përfaqësoni është si ajo drita në fund të tunelit. Është si ajo shpresa njerëzore që nuk vdes asnjëherë sepse me operacionet ku merr pjesë njësia juaj, ku ka marrë pjesë njësia juaj, me operacionet luftarake, por edhe me misionet paqeruajtëse dhe me të gjitha ndërhyrjet që komandot kanë bërë ndër vite për të siguruar jetët njerëzore në raste të krizave të shumta, të fatkeqësive natyrore apo edhe të misioneve paqeruajtëse dhe misioneve luftarake, kanë qenë realisht ajo shpresa që i është dashur njerëzve që i është kërcënuar jeta", u shpreh ministrja Xhaçka përpara komandove të rinj. Më tej, ministrja Xhaçka deklaroi se qeveria do të ketë një trajtim më të mirë për ushtarakët shqiptarë. "Ju jemi shumë mirënjohës për misionin që përmbushni si Forca Komando dhe dua t'ju them se angazhohem personalisht, por edhe qeveria edhe kryeministri, për të treguar kujdes shumë më të madh ndaj jush, vëmendje shumë më të madhe ndaj jush, por edhe trajtim shumë më të mirë për ju. Angazhohem që viti tjetër do të jetë një vit shumë më i mirë për komandot, siç do të jetë një vit shumë më i mirë për trajtimin e Forcave të Armatosura në përgjithësi",- shtoi ajo.

**KOMANDOT**

"Kjo është një njësi elitë e Forcave tona të Armatosura dhe ju jeni bërë pjesë e saj, dhe për këtë pa diskutim që do të keni një përgjegjësi shumë të madhe dhe pritshmëritë që ne kemi për ju janë vërtetë pa kufi, ashtu sikundër janë pa kufi edhe shpresat njerëzore kur jetët janë nën kërcënim. Ajo që ju përfaqësoni është si ajo drita në fund të tunelit", - u shpreh ministrja Xhaçka.


Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, dje me ushtarët e rinj

### Mori peng 13 persona, zbardhet e shkuara kriminale e 41-vjeçarit

# Terror në gjykatën greke: Shqiptari Dritan Mullahu tenton të vrasë personazhin e famshëm

## *Mediat greke: Akuzonte familjen Panagaku për divorcin me gruan*

Tmerri dhe paniku kanë pushtuar një sallë gjyqësore në zonën Gjithio të Greqisë, ku një shqiptar, shtetasi Dritan Mullahu, ka nxjerrë një armë dhe ka tentuar të vras një personazh të njohur grek, si dhe ka marrë peng 13 persona. Mediat e shtetit fqinj raportuan se në seancën gjyqësore po gjykohej padia e familjes greke, shefe kuzhinë e mirënjohur nga televizionet, Maria Panagaku, për intrige, keqpërdorim të emrit dhe mashtrim. Ndërsa shqiptari Mullahu ishte në rolin e dëshmitarit, i cili kishte shprehur hapur urrejtjen ndaj familjes greke Panagaku, të cilët i akuzonte për divorcin me gruan.

**NGJARJA**

Mesditën e së enjtes policia greke vuri në pranga një 41-vjeçar shqiptar, pasi akuzohet për tentativë vrasje me paramendim, vjedhje shkelje e ligjit të armëve dhe ndërprerje të procesit gjyqësor në seancë. Konkretisht gjatë seancës ku po gjykohej padia e familjes greke Panagku, shqiptari Dritan Mullahu krejt papritur ka nxjerrë një pistoletë me 3 fishekë dhe e ka vendosur në kokën e djalit të Panagarku-t duke e kërcënuar me vdekje. Një police e re, e cila ndodhej në sallën e gjyqit, nënë e një fëmijë 5-vjeçar, ka tentuar ta qetësojë dhe t'i marrë armën, atëherë Mullahu ka tërhequr këmbëzën ndaj saj, por arma nuk shkrepi. Dëshmitarët të shokuar pohojnë se vrasja u shmang pasi edhe pse Mullahu shkrepi, arma nuk shtiu. Në ato momente policja ka hedhur poshtë armen e saj për të qetësuar gjakrat, por kjo nuk mjaftoi. Shqiptari rrëmbeu armën e policës dhe mori peng të 13 personat, të cilët ishin të pranishëm në sallën e gjyqit. Mësohet se ishte ndërhyrja e policisë ajo që çoi në përfundimin e këtij episodi të frikshëm dhe arrestimin e 41-vjeçarit.

Qytetarët, të cilët ishin të pranishëm në sallë, pas arrestimit të shqiptarit treguan momentet e tmerrit që kishin përjetuar. "Dritan Mullahu, ishte thirrur si dëshmitar në një çështje ku njërën nga palët në konflikt ai e urrente për shkak se kishin marrë në punë ishbashkëshorten e tij pas divorcit. Ndërsa gjyqi kishte filluar, ai i ka vënë në ballë revolverin atij personi, duke i thënë 'më ke shkatërruar jetën, do të vdesësh'", është shprehur qytetari, i cili ishte i pranishëm në sallën gjyqësore. Bëhet me dije se Dritan Mullahu është liruar pak kohë më parë nga burgu, pasi ishte dënua për rrëmbim të miturish dhe trafik emigrantesh të paligjshëm. Mësohet se shkak i konflikteve të tij me familjen greke Panagaku ishte ish-bashkëshortja e tij. Mullahu akuzonte këtë familje për divorcin me gruan, kjo pasi bashkëshortja shqiptare e 41-vjeçarit ka gjetur punë e strehë në shtëpinë e Panagakut, pasi dhunohej vazhdimisht nga



Foto ilustruese

**KËRCËNIMI**

Një police e re, e cila ndodhej në sallën e gjyqit, nënë e fëmijë 5-vjeçar, ka tentuar ta qetësojë dhe t'i marrë armën, atëherë Mullahu ka tërhequr këmbëzën ndaj saj, por arma nuk shkrepi. Në ato momente policja ka hedhur poshtë armën e saj për të qetësuar gjakrat, por kjo nuk mjaftoi. Shqiptari rrëmbeu armën e policës dhe mori peng të 13 personat, të cilët ishin të pranishëm në sallën e gjyqit.



## SHKURTE

### Grabitet supermarketi në Tiranë, autorët ende të paidentifikuar

Tre persona ende të paidentifikuar kanë thyer xhamat e një supermarketi në Tiranë dhe kanë marrë kasafortën. Ngjarja ka ndodhur mëngjesin e sotëm në rrugën "Medar Shtylla". Tre autorët nuk janë mjaftuar vetëm me marrjen e kasafortës së supermarketit, por kanë marrë edhe sende të tjera dhe janë larguar me një makinë. Policia vijon hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorëve. "Më datë 18.05.2018, tek kryqëzimi i rrugës "Medar Shtylla", 3 persona ende të paidentifikuar, kanë thyer xhamat e një supermarketi, ku kanë marrë kasafortën, sende të ndryshme dhe janë larguar me një mjet. Po punohet për identifikimin e kapjen e autorëve"- thuhet në njoftimin e policisë.

### Plagosën me thikë 27-vjeçarin për vendin e parkimit, arrestohen babë e bir

Policia e Tiranës ka vënë në pranga babë e bir pas sherrit të ndodhur dy net më parë në zonën e "Komunës së Parisit" ku u plagos me thikë një 27-vjeçar. Mësohet se shkak i sherrit u bë një vend parkimi. "Në lidhje me ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e së enjtes në zonën e "Komunës të Parisit", si pasojë e një konflikti për motive të dobëta mbeti i dëmtuar me mjet prerës shtetasi D. L., rreth 27 vjeç",-thuhet në njoftimin e policisë. Autorët e arrestuar janë shtetasit Edmond Merkaj, 53 vjeç dhe Edjano Merkaj, 23 vjeç, banues në Tiranë.

### Marku në Paris, në konferencën e Rrjetit të Prokurorëve Publikë të BE-së

Kryeprokurorja Arta Marku zhvilloi ditën e djeshme një takim me Prokurorin e Përgjithshëm të Gjykatës së Kasacionit të Francës, Jean - Claude Marin. Takimi u zhvillua në kuadër të konferencës së 10-vjetorit të Rrjetit të Prokurorëve Publikë, ose institucioneve ekuivalente të Gjykatave Supreme të vendeve të Bashkimit Evropian, që u zhvillua nga 16-18 maj 2018, në Paris. Ftesa për Markun u dërgua nga Jean-Claude Marin, Prokurori i Përgjithshëm pranë Gjykatës së Kasacionit të Francës dhe kryetar i Rrjetit të Prokurorëve ose institucioneve ekuivalente të Gjykatave Supreme të vendeve të Bashkimit Evropian i quajtur ndryshe "Rrjeti Nadal".

## "Larg policisë raciste, kërkojmë drejtësi"!

# 27-vjeçari u gjet i vdekur në paraburgim, familjarët protestojnë me arkivolin në duar




**KORÇË** - Enea Ftoj, i cili dy ditë më parë u gjet i vdekur në dhomat e paraburgimit në komisariatin e Korçës, dje u përcoll në banesën e fundit. Para varrimit, familjarë, të afërm dhe pjesëtarë të komunitetit rom në këtë qytet protestuan përpara komisariatit me arkivolin e tij në krahë, duke akuzuar policinë si shkaktare. Familjarët e 27-vjeçarit janë të bindur se vdekja e tij në komisariatin e Korçës nuk ishte natyrale, por e shkaktuar nga dhuna çnjerëzore. Me pankarta në duar ku shkruhej: "Larg policisë raciste", "Duam drejtësi" dhe "Jo dhunë dhe padrejtësi, por dashuri dhe drejtësi", ata bënë thirrje që përgjegjësit e vdekjes së babait të tre fëmijëve të përballen me ligjin. I riu u gjet i pajetë në qelitë e paraburgimit mëngjesin e së enjtes, ndërsa pritej që dje do të dilte në sallën e gjyqit për t'u njohur me masën e sigurisë. Mësohet se ai ishte arrestuar pak ditë më parë për vjedhje me dhunë. Pas lajmit të kobshëm reaguan ashpër familjarët, të cilët akuzuan policinë se i vranë djalin. Madje, ata publikuan edhe pamje të trupit të pajetë, ku dukeshin qartë shenjat e dhunës në fytyrë, kokë, krahë dhe shpatulla. Për afro katër orë, tre ekspertë mjekoligjorë (dy të pavarur dhe një i Institutit të Mjekësisë Ligjore) kanë kryer ekspertizën, ndërkohë që përgjigjet pritet të dalin pas tri javësh.

## Hetuesit: Organizator i dhunimit të së miturës, fqinji i saj, Jorges Dosti

# "Tre persona më sulmuan në oborrin e banesës, më lidhën sa hap e mbyll sytë"

## 13-vjeçarja: Nuk munda të nxjerr zë e të kërkoj ndihmë. U tmerrova, falë Zotit më shpëtuan prindërit e gjyshja

Ervis Kuçi

**FIER**

Të dielën në mbrëmje u nisa për te xhaxhai për të parë emisionin humoristik "Portokalli", por sapo dola në oborr, tre persona më sulmuan befasisht. Ata më lidhën sa hap e mbyll sytë dhe më tërhoqën zvarrë. Nuk munda të nxjerr zë, të kërkoj ndihmë, pasi gjithçka ndodhi shumë shpejt. Jam tmerruar nga ajo që ndodhi. Isha me fat se më shpëtuan prindërit dhe gjyshja". Kështu ka deklaruar para hetueses të çështjes dhe në prani të psikologes, vajza 13-vjeçare e familjes Lushka në fshatin Arapaj të Roskovecit, e cila pak ditë më parë u mor peng nga tre të rinj, që tentuan ta përdhunonin në një banesë në ndërtim e sipër.

**DËSHMIA E 13-VJEÇARES**

Pas ngjarjes së rëndë e mitura (nxënëse në klasën e 7-të) ka thënë se kanë qenë 3 persona që e rrëmbyen, ku mes tyre ajo ka njohur edhe dy bashkëfshatarët Jorges Dosti dhe Marjus Çalalamëni, tashmë të arrestuar së bashku me të riun Redon Tereziu nga fshati Vlosh i Roskovecit. "Personat që më morën me forcë përfituan, pasi oborri ishte i pandriçuar. Shtëpia jonë është në fund të fshatit, ndaj nuk kishte njeri në rrugë. Ata më çuan në anën tjetër të rrugës tek një shtëpi që po ndërtohej, edhe kjo pa ndriçim. Falë Zotit, nëna, babai dhe gjyshja erdhën aty shumë shpejt dhe unë shpëtova nga duart e tyre. Familjet e mi më gjetën të lidhur", ka dëshmuar 13-vjeçarja. Ndërkaq, edhe nëna e të miturës, Manushaqe Lushka ka deklaruar se e ka gjetur të bijën të lidhur. "Jo vetëm duart, por edhe gojën ia kishin lidhur me litar", është shprehur para hetuesve kjo e fundit. Ky fakt është konstatuar edhe nga ekspertiza mjeko-ligjore prej nga është konkluduar se si pasojë e shtrëngimit të litarëve, vajzës i janë shkaktuar dëmtime në këmbë, duar dhe në gojë. Por, fatmirësisht nga mjeko-ligjorët është konstatuar se tre agresorët nuk kanë mundur të kryejnë marrëdhënie seksuale me të miturën.

**HETIMI**

Nga këqyrja e vendit të ngjarjes është konstatuar se tre të dyshuarit kanë vepruar me paramendim, pasi ishin kujdesur edhe të vendosnin shtroje në vendin ku do të kryenin krimin e tyre. Ndonëse familjarët e Marjus Çalamënit kanë pretenduar se 24-vjeçari ka qenë duke vjelë domate në momentin e ngjarjes dhe se biçikletën ua kishte dhënë shokëve të tij, nga hetimet paraprake është konkluduar se të tre të arrestuarit, Jorges Dosti, Marjus Çalamëni dhe Redion Tereziu kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin për kryerjen e këtij krimi. Mësohet se nga përgjimet ambientale të kryera pas shoqërimit të tre të rinjve, ata kanë diskutuar me njëri-tjetrin se si do të deklaronin kur të merreshin në pyetje. Nga përgjimet ka rezultuar se 24-vjeçari Jorges Dosti ka qenë edhe organizatori i planit për përdhunimin e të miturës. Ai mësohet t'u ketë thënë dy shokëve që të mos e pranojnë ngjarjen. Marjus Çalamëni u ka kërkuar mendim dy shokëve se si do justifikonte faktin se në vendngjarje kishte mbetur biçikleta e tij. Jorgesi e ka këshilluar të shprehet se biçikletën ia kishte dhënë një shoku dhe nuk e di se ku e kishte lënë ai. Po ashtu, nga përgjimet dhe hetimet e deritanishme është konkluduar se Dosti, që ishte edhe fqinj me të miturën ka planifikuar dhe organizuar krimin, ndërsa është ndihmuar nga dy shokët e tij Redion Tereziu dhe Marjus Çalamëni, ku ky i fundit mësohet të ketë luajtur rolin e rojës deri në momentin që u zbuluan nga familjarët e 13-vjeçares. Nisur nga këto prova që prokuroria i ka paraqitur ditën e djeshme gjykatës, kjo e fundit ka vendosur të caktojë masën e sigurisë "arrest në burg" ndaj tre të ndaluarve, masë që pritet të rivlerësohet nga gjykata e të miturve në Vlorë, ku edhe do të zhvillohen procedurat e mëtejshme të kësaj çështjeje për shkak të kompetencës. Tre të arrestuarit e sipërcituar akuzohen për veprat penale "Heqje e paligjshme e lirisë" dhe "Marrëdhënie seksuale me të mitur" e mbetur në tentativë, parashikuar nga Nenet 110/2, 100 e 22 të Kodit Penal. Ngjarja e ndodhur ka lënë pasoja të pariparueshme tek e mitura, pasi sipas familjarëve, veç tronditjes psikologjike dhe dëmtimeve fizike, ata janë detyruar që ta largojnë nga fshati dhe nga shkolla e saj, me qëllim që të mospërballet me mentalitetin e moshatarëve të banorëve të tjerë të fshatit.


Nëna e 13-vjeçares, Manushaqe Lushka


Shtëpia ku u tentua përdhunimi i 13-vjeçares

**NËNA E TE MITURËS**

"Jemi tejet të tronditur nga ajo që ndodhi. Ata që më bënë me njollë çupën, të varen në litar. Vajza do ikte të shikonte televizor tek xhaxhai si gjithmonë. Atë e kanë kapur, e kanë marrë zvarrë. Autorët i pashë që dolën nga dritarja e banesës që është në ndërtim e sipër. Matanë rrugës është kjo shtëpia e papërfunduar ende dhe shkuam aty me burrin. Vajzën e gjeta të lidhur me litar", u shpreh mes lotësh nëna e 13-vjeçares, Manushaqe Lushka.

**PËRGJIMET**

Nga përgjimet ka rezultuar se 24-vjeçari Jorges Dosti ka qenë edhe organizatori i planit për përdhunimin e të miturës. Ai mësohet t'u ketë thënë dy shokëve që të mos e pranojnë ngjarjen. Marjus Çalamëni u ka kërkuar mendim dy shokëve se si do justifikonte faktin se në vendngjarje kishte mbetur biçikleta e tij. Jorgesi e ka këshilluar të shprehet se biçikletën ia kishte dhënë një shoku dhe nuk e di se ku e kishte lënë ai.



## Qëlloi me kallashnikov brenda në lokal, kapet 31-vjeçari

**VLORË** - Të shtënat me kallashnikov brenda ambienteve të një lokali kanë shkaktuar panik në Vlorë. Burime nga policia lokale bënë me dije se ngjarja ndodhi rreth orës 17:39 të ditës së djeshme në vendin e quajtur "Sahati". Mësohet se 31-vjeçari Besmir Gjela ka hyrë i armatosur brenda në lokal (loto) dhe ka hapur zjarr. Fatmirësisht, nga të shtënat me armë zjarri nuk ka pasur persona të lënduar. Pranë ambienteve të lokalit ka pasur edhe disa efektivë policie, të cilët kanë ndërhyrë menjëherë, duke shmangur kështu një ngjarje të rëndë, pasi autori ka pasur në shënjestër një person tjetër. Blutë kanë arrestuar autorin, ndërsa i është sekuestruar edhe arma në cilësinë e provës materiale. Burimet e mësipërme sqaruan se gjatë momentit të arrestimit, 31-vjeçari ka tentuar të largohet dhe është përplasur me xhamat, duke pësuar lëndime të lehta në trup. Ndërkohë, vijojnë hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje. Materialet procedurale në ngarkim të Besmir Gjelës i janë dërguar prokurorisë së Vlorës për hetime të mëtejshme.

## Drama, dy muaj më parë u zhduk vëllai i 26-vjeçarit

# Gjendet trupi i pajetë i të riut, dyshohet për vetëvrasje

**VLORË** - Një 26-vjeçar është gjetur i pajetë pranë sheshit "Flamuri" në Vlorë, ndërsa sipas policisë, dyshohet se ka vrarë veten. Kanë qenë kalimtarët e rastit, ata që kanë pikasur një person të shtrirë përtokë, ndërsa kanë lajmëruar policinë. Menjëherë blutë kanë mbërritur në vendngjarje dhe kanë bërë të mundur identifikimin e të riut. Bëhet fjalë për Albano Imerajn, banues në këtë qytet. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, blutë deklaruan se dyshohet që i riu i ka dhënë fund jetës, pasi në vendin e ngjarjes është gjetur edhe një thikë. Fillimisht u dyshua se Imeraj ka vdekur nga mbidoza. Kjo për faktin se kohë më parë njihej si përdorues droge. Albano Imeraj prej kohësh kishte shfaqur probleme, për shkak edhe të ngarkesës psikologjike, pasi rreth dy muaj më parë është zhdukur edhe vëllai i tij, Ksandro Imeraj. Ky i fundit ishte duke lundruar me një "Jet Sky" në zonën e Karaburunit e pak ditë më vonë motori i tij u gjet në Mal të Zi.

Policia: Pasuritë i tjetërsoi në emër të motrës, dhëndrit dhe dajës

# U kap në Mal të Zi me 1 ton marijuanë, sekuestrohen pasuritë e shkodranit

## *Ndue Vesel Pepaj u arrestua në vendin fqinj si kreu i një organizate të trafikut të drogës*

**SHKODËR**

Policia e Shtetit në bashkëpunim me prokurorinë e Shkodrës kanë sekuestruar 7 pasuri të paluajtshme në fshatin Bajzë të Malësisë së Madhe në pronësi të Ndue Vesel Pepaj, i cili është arrestuar në Mal të Zi si kreu i një organizate kriminale, që merrej me trafikimin dhe shitjen e lëndëve narkotike. Pepaj u prangos nga policia malazeze në 17 dhjetor 2017, bashkë me 11 persona të tjerë. Ndërkohë, burime zyrtare nga policia dje bënë me dije se Ndue Vesel Pepaj, këto pasuri të sekuestruara i ka ricikluar duke i tjetërsuar në emër të personave të tjerë, sidomos në emër të motrës, dhëndrit dhe dajës së tij. Ai akuzohet për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".

**HETIMI**

Pas disa muajsh hetime të prokurorisë së Shkodrës në bashkëpunim me njësinë hetimore të Task-Forcës speciale qendrore në Policinë e Shtetit, dje u ekzekutua vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër, e cila pas kërkesës së organit të prokurorisë kishte vendosur sekuestron preventive të 7 pasurive të paluajtshme. Bëhet fjalë për tokë me sipërfaqe rreth 15500 m2 dhe ndërtesa social-ekonomike me sipërfaqe rreth 450 m2, ku përfshihen bar-restorant, hotel "Kavaliero", lavazh dhe dyqan cigaresh në fshatin Bajzë të njësisë administrative Kastrat, Bashkia Malësi e Madhe, në pronësi të shtetasit Ndue Vasel Pepaj dhe familjarëve të tij. Sipas burimeve zyrtare nga policia, sekuestrimi u krye në funksion të hetimeve të procedimit penal të vitit 2018, për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale". Mësohet se bazë për fillimin e këtij hetimi ka shërbyer njoftimi i ardhur nga autoritetet e Mali të Zi më 17 dhjetor 2017. Atë ditë (më 17 dhjetor të vitit që shkoi), rreth orës 16:00, autoritetet malazeze në kuadrin e operacionit "Mashtrim" ("Trick"), arrestuan 12 persona, përfshirë edhe shtetasin shqiptar Ndue Vasel Pepaj, banues në Bajzë, Malësi e Madhe, si kreun e një organizate kriminale që vepronte në Mal të Zi dhe që merrej me trafikimin dhe shitjen e lëndëve narkotike.

**OPERACIONI ANTIDROGË**

Gjatë këtij operacioni janë gjetur dhe konfiskuar 982 kg marijuanë, 1,7 kg heroinë dhe rreth 3 kg përzierës. Sipas policisë malazeze, kjo organizatë kriminale dyshohet se kishte vepruar për një periudhë të gjatë kohore dhe veçanërisht aktive ka qenë që nga 1 janari 2016 në trafikimin dhe shitjen e lëndëve narkotike në nivel ndërkombëtar. Hetimet po zhvillohen në bashkëpunim edhe me Prokurorinë Speciale të Malit të Zi, përfaqësues të së cilës u takuan me autoritetet ditën e fundit në prokurorinë e Shkodrës në funksion të hetimit të kësaj çështjeje dhe të ekzekutimit të letër-porosive së kërkuara në mënyrë reciproke nga autoritet gjyqësore të të dy shteteve.

**SEKUESTRIMI I PASURISË**

Hetimi dhe sekuestrimi i aseteve është bërë, pasi dyshohet se këto pasuri janë produkt i veprimtarisë kriminale të trafikimit të narkotikëve, të kryer nga shtetasi Ndue Vesel Pepaj. Sipas hetuesve të çështjes, më pas Pepaj këto pasuri i ka ricikluar duke i tjetërsuar në emër të personave të tjerë, sidomos në emër të motrës, dhëndrit dhe dajës së tij. Zbatimi i vendimit të gjykatës për ekzekutimin e sekuestrimit u bë në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, Drejtorinë e Hetimit Tatimor Shkodër dhe Agjencinë e Menaxhimit të Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila mori në administrim pasuritë e sekuestruara. Hetimet për këtë çështje vazhdojnë, me qëllim dokumentimin e plotë të veprimtarisë kriminale.

**1 TON**

Më 17 dhjetor të vitit 2017, policia malazeze sekuestroi një sasi prej afro 1 ton marijuanë, 1,7 kg heroinë dhe rreth 3 kg përzierës. Gjatë operacionit të koduar "Mashtrim" ("Trick") u arrestuan 12 persona, përfshirë edhe shtetasin shqiptar Ndue Vasel Pepaj, banues në Bajzë të Malësisë së Madhe. Sipas policisë malazeze, Pepaj ishte kreu i një organizate kriminale që merrej me trafikimin dhe shitjen e lëndëve narkotike.


Ndue Vesel Pepaj, i arrestuar në Mal të Zi


Hotel "Kavaliero" i sekuestruar nga policia

**PASURITË E SEKUESTRUARA**

- Tokë me sipërfaqe rreth 15500 m².

2. Ndërtesa social-ekonomike me sipërfaqe rreth 450 m², ku përfshihen:
   - Bar-restorant
   - Hotel "Kavaliero"
   - Lavazh
   - Dyqan cigaresh


EPSA enforcement private service

**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"**
**SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:**

1. **Are** me nr.33/26, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099,vol.11, fq.202, me sip.2,000 m2, cmimi që do të shitet është **3.548.664** lekë.
2. **Are** dhe truall me **nr.1/88**, e ndodhur ne Qerret, Kavaje, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.9, fq.34, me sip.1,770 m2 cmimi që do të shitet është **8.793.590** lekë.
3. **Are** me nr.33/27, e ndodhur ne Karpen. Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099, vol.1, fq.203, me sip.4,050 m2 cmimi që do të shitet është **7.186.045** lekë.
4. **Are** me nr.70/9, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.2, fq.106, me sip.6,460 m2 cmimi që do të shitet është **4.584.875** lekë.
5. **Njësi** me nr.15/22+1-N1 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/69, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.116 m2 vlerësohet me vlerën e **9.056.191** lekë.
6. **Njësi** me nr.15/22+1-N2 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/70, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.91 m2 vlerësohet me vlerën e **7.104.426** lekë.
7. **Njësi** me nr.15/22+1-N3 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/71, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.95 m2 vlerësohet me vlerën e **7.416.708** lekë.
8. **Njësi** me nr.15/22+1-N4 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/72, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.211 m2 vlerësohet me vlerën e **16.472.899** lekë.
9. **Bodrum** me nr.15/22+1-B e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 130/176, vl.2005-2007, datë 24.09.2007 me sip.609 m2 vlerësohet me vlerën e **13.261.358** lekë.Te gjitha pasurite e sipërcituara jane hipotekuar në favor te **Banka Raiffeisen sha.** Prsh Casa Nostra.

Ankandi zhvillohet ne **datë 11.06.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane. Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al


# Transportonin kanabis në makinë, bien në pranga 3 vlonjatët, në kërkim një tjetër

**TEPELENE** - Tre persona nga Vlora janë arrestuar nga forcat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut të Gjirokastrës, pasi iu është gjetur dhe sekuestruar një sasi prej 31,45 kg kanabis sativa. Bëhet fjalë për shtetasit Klerdi Graçi 33 vjeç, Aulon Milo 31 vjeç dhe Aleksandros Vasili, 26 vjeç. Ndërkohë është shpallur në kërkim 31-vjeçari E.Zh., banues në Tepelenë. Mësohet se droga u kap në aksin rrugor Bënçë-Progonat, në afërsi të fshatit Bënçë gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin tip "Opel" me targa AA927RJ me drejtues mjeti një shtetas, i cili ka arritur të largohet dhe pasagjer shtetasin Klerdi Graçi. Ndërsa shtetasit Aulon Milo, Aleksandros Vasili dhe E.ZH. bënin hapjen e rrugës me automjetin tip "Audi", me targa AA 204 SL dhe me automjetin tip "Jeep" pa targa. U bë sekuestrimi i lëndës narkotike dhe mjeteve. Materialet në ngarkim të personave të mësipërm i kaluan prokurorisë së Gjirokastrës për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" e kryer në bashkëpunim.



## ARSIMI I LARTË

### PRANIMET

Degët e mësuesisë, mund të hyjnë vetëm kandidatët me notë mesatare mbi shtatë

Voltiza Duro

# Vendimi, ja sa duhet mesatarja për t'u pranuar në universitet

*"Programet profesionale 2 -vjeçare, jo kritere në notë"*

Është përcaktuar kriteri i notës mesatare për pranimin e kandidatëve në nivelin bachelor si dhe në programet e integruara të studimit në master për vitin akademik 2018-2019. Ky vendim është miratuar ditën e djeshme nga Këshilli i Ministrave në të cilin përcaktohet mesatarja e pranimit të studentëve gjatë transferimit të studimeve në vitet e ndërmjetme. "Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose për të transferuar studimet në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në këtë vendim",-theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë të fundit, gjithashtu, bëhet me dije se për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, nota mesatare për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose për të transferuar studimet në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019, të jetë nota 6 (gjashtë). "Ndërkohë nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë vijon: a) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë. b) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore",-thuhet në vendim. Ashtu siç është bërë me dije më parë nga përfaqësuesit e MASR dhe vetë ministrja Lindita Nikolla, për kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimit të fushës së mësuesisë, për vitin akademik 2018-2019, nota mesatare e përllogaritur, do të jetë nota shtatë.

**NOTA MESATARE**

Bëhet me dije se për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, nota mesatare për pranimin në programet e studimit të ciklit për vitin akademik 2018-2019, të jetë nota 6 (gjashtë).



Foto Ilustruese

**PROGRAMET PROFESIONALE**

Ndërkohë kandidatët që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi. Në këtë të fundit bëhet me dije se institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe njësitë arsimore vendore janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. "Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, dhe përllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë kryhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Në rastet kur nuk aplikohen provimet e Maturës Shtetërore, komisioni përkatës përcakton mënyrën e përllogaritjes së notës mesatare"-thuhet në vendim.

**Faksimile e vendimit të Këshillit të Ministrave mbi pranimet në Universitete**

| Nr. | INSTITUCIONI I ARSIMIT TE LARTË | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
|---|---|---|---|
| 1 | Universiteti i Tiranës | Biologji | 7 |
| 2 | | Filozofi | 7 |
| 3 | | Fizikë | 7 |
| 4 | | Gjeografi | 7 |
| 5 | | Gjuhë angleze | 7 |
| 6 | | Gjuhë angleze (Sarandë) | 7 |
| 7 | | Gjuhë frënge | 7 |
| 8 | | Gjuhë gjermane | 7 |
| 9 | | Gjuhë greke | 7 |
| 10 | | Gjuhë italiane | 7 |
| 11 | | Gjuhë - letërsi | 7 |
| 12 | | Gjuhë ruse | 7 |
| 13 | | Gjuhë spanjolle me profil gjuhë - letërsi dhe qytetërim hispanik | 7 |
| 14 | | Gjuhë turke | 7 |
| 15 | | Histori | 7 |
| 16 | | Informatikë | 7 |
| 17 | | Kimi | 7 |
| 18 | | Matematikë | 7 |
| 19 | | Psikologji | 7 |
| 20 | | Sociologji | 7 |
| Nr. | Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | | Biologji - kimi | 7 |
| 2 | | Edukim qytetar | 7 |
| 3 | | Filozofi - sociologji | 7 |
| 4 | | Gjeografi dhe gjuhë italiane | 7 |
| 5 | | Gjuhë - letërsi | 7 |
| 6 | | Gjuhë angleze | 7 |
| 7 | | Gjuhë frënge | 7 |
| 8 | | Gjuhë gjermane | 7 |
| 9 | | Gjuhë italiane | 7 |
| 10 | | Histori - gjeografi | 7 |
| 11 | | Histori dhe gjuhë gjermane | 7 |
| 12 | | Matematikë informatike | 7 |
| 13 | | Matematikë - fizikë | 7 |
| 14 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7 |
| 15 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7 |
| 16 | | Psikologji | 7 |
| Nr. | Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | | Gjermanisht-anglisht | 7 |
| 2 | | Gjuhë angleze | 7 |
| 3 | | Gjuhë - letërsi - anglisht | 7 |
| 4 | | Histori | 7 |
| 5 | | Informatikë - anglisht | 7 |
| 6 | | Matematikë - informatikë | 7 |
| 7 | | Mësuesi për arsim fillor | 7 |
| 8 | | Mësuesi për arsim parashkollor | 7 |
| 9 | | Psikologji sociologji | 7 |
| Nr. | Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | | Biologji - kimi | 7 |
| 2 | | Gjuhë - letërsi shqipe | 7 |
| 3 | | Gjuhë - letërsi angleze | 7 |
| 4 | | Gjuhë - letërsi dhe qytetërim grek | 7 |
| 5 | | Gjuhë - letërsi italiane | 7 |
| 6 | | Histori - gjeografi | 7 |
| 7 | | Matematikë - informatikë | 7 |
| 8 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7 |
| 9 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7 |
| 10 | | Fizikë dhe teknologji informacioni | 7 |
| Nr. | Universiteti "Fan S. Noli", Korçë | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | | Biologji - kimi | 7 |
| 2 | | Filozofi - sociologji | 7 |
| 3 | | Gjuhë angleze | 7 |
| 4 | | Gjuhë dhe kulturë frënge | 7 |
| 5 | | Gjuhë - letërsi | 7 |
| 6 | | Histori - gjeografi | 7 |
| 7 | | Matematikë - fizikë | 7 |
| 8 | | Matematikë - informatikë | 7 |
| 9 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7 |
| 10 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7 |
| Nr. | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | | Biologji | 7 |
| 2 | | Fizikë | 7 |
| 3 | | Gjuhë angleze | 7 |
| 4 | | Gjuhë italiane | 7 |
| 5 | | Gjuhë shqipe dhe letërsi | 7 |
| 6 | | Histori - gjeografi | 7 |
| 7 | | Informatikë | 7 |
| 8 | | Kimi | 7 |
| 9 | | Matematikë | 7 |
| 10 | | Mësuesi për arsimin fillor | 7 |
| 11 | | Mësuesi për arsimin parashkollor | 7 |
| 12 | | Pedagogji e specializuar | 7 |
| Nr. | Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër | PROGRAMI I STUDIMIT | NOTA MESATARE |
| 1 | | Biologji - kimi | 7 |
| 2 | | Fizikë | 7 |
| 3 | | Gjeografi | 7 |
| 4 | | Gjuhë - letërsi | 7 |
| 5 | | Gjuhë angleze | 7 |
| 6 | | Gjuhë frënge | 7 |
| 7 | | Gjuhë gjermane | 7 |
| 8 | | Gjuhë italiane | 7 |

PERKTHYESI

# DIANA OMARI:

## Kur priste ngushëllime me kravatë të kuqe, përkthimet e Selfos nën presionin e vdekjes

Fatmira Nikolli

*"Ju rrëfej kunatin tim dhe fatin e trishtë të shqipëruesit të kryeveprave"*

*"Dy vëllezër ia pushkatuan, edhe pse njëri i dha Enver Hoxhës borxh kostumin e dasmës"*

Nga Guliveri shqiptar te robinsonada e përkthimit: me 'Djemtë e rrugës Pal', "Rreth botës për 80 minuta". Zor se një fjali ia del të përmbledhë jetën e stuhishme të një 46-vjeçari, që kur u nda nga jeta la pas tre fëmijë të mitur dhe 50 vepra të përkthyera.

Vetëm "Udhëtimet e Guliverit", ndër vise të largëta të dheut, i përkthyer nga Halit Selfo, që qe botuar nga Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve në Tiranë më 1958 e pati tirazhin 10 mijë kopje.

Ai kishte përkthyer nga disa gjuhë, frëngjishtja, italishtja, anglishtja, ndaj kishte shqipëruar "Zemra" të De Amicis, "Djemtë e rrugës Pal" të Ferenc Molnar, "Udhëtimet e Guliverit", "Konti i Monte Kristos" të Dymasë dhe një seri veprash të Zhyl Vernit, nisur nga "Djemtë e rrugës Pal".



Halit Selfo

Në shtëpizën e vogël ku jetonte, kishte marrë edhe familjen e së shoqes, edhe ajo e përndjekur politike. Jetonin 10 veta në një dhomë, ndaj shpesh, kur Halit Selfo donte qetësi, e kishte zakon të shkonte në hotel Vollga, të merrte një dhomë e të përkthente si duhej, kur dhimbjet e linin.

"Kur përktheu '20 mijë lega nën det' kishte specie që nuk i njihte. Haliti shkoi në Durrës e gjeti peshkatarë të vjetër, foli me ta gjerë e gjatë, derisa sa mësoi ç'i duhej për detin. Përktheu 50 vepra para se të vdiste, të fundit e përktheu me dhimbjen e katër tumoreve në kokë, ashtu i qetë, i pafjalë". Përshkrimet e Diana Omarit, kunatës që Haliti e pat marrë në shtëpinë e tij dhe e pat rritur, të flasin për një burrë që përkthente e punonte, sikur gjithë dhimbja e botës, të fashitej vetëm prej punës. Atëkohë, ia patën pushkatuar dy vëllezër, e njërin, për bombën në Legatën Jugosllave. Ditën pas pushkatimit, Haliti kish vënë një kravatë të kuqe, e kish shkuar në punë, duke i pritur ngushëllimet me fjalën "mirëmëngjes". Por dhimbja e shtrënguar fort vetëm për vete, e mundi shpejt dhe ai ndërroi jetë në moshën 46-vjeçare. Sapo kish dorëzuar "Kontin e Monte Kristos" për botim.

Ai kishte lindur më 1918 në një familje tregtarësh gjirokastritë. Kishte ndjekur Liceun Francez në qytetin e Korçës, e mandej pat shkuar të kryente studimet e larta në Padova për Ekonomi-Biznes. Pushtimi fashist i Shqipërisë e detyroi të kthehej në atdhe dhe të merrte pjesë në luftën antifashiste. Pas çlirimit pat punuar redaktor në gazetën ushtarake "Luftëtari". U burgos si "Armik i Popullit" dhe e vuajti dënimin në burgun e në kampin famëkeq të Maliqit. Pas lirimit nisi përkthimet e letërsisë botërore, fillimisht si punonjës i jashtëm i ndërmarrjes "Naim Frashëri" dhe më pas i përhershëm. Sot renditet ndër mjeshtrit e përkthimit mes Sotir Cacit, Vedat Kokonës, Spiro Çomorës etj. Në 100 vjetorin e lindjes së tij, "Botimet Zenit" kanë risjellë veprat e Selfos dhe një përkujtimore që u mbajt në stendën e Zenit, në Festivalin "Ditënetët e Librit" që mbahet në Muzeun Historik Kombëtar (16-20 maj). Ndërkaq, "GSH" në një bisedë me Diana Omarin, kunatën e Halit Selfos, sjell një portret të njeriut e përkthyesit, demiurgut të gjuhës.

**-Si e mbani mend Halit Selfon?**

Kur u martua ime motër kam qenë vetëm 10 vjeçe. Kam qenë si një fëmijë i tij që edhe në krevat më ka mbajtur. Kur kemi ardhur në Tiranë kam qenë 14 vjeç. Nga ana njerëzore Haliti ka qenë një njeri i mrekullueshëm, shumë zemërbardhë, shumë bujar, shumë i gjindshëm. Për gjithë njerëzit sakrifikonte gjithçka nga vetja e vet, vetëm që të plotësonte dëshirat dhe nevojat e njerëzve.

Unë i jam mirënjohës edhe në emër të familjes sime, që na hoqi nga baltërat e Fierit, ku po na hanin të gjallë, ku na kishin degdisur për shkak të biografisë që kishim. Ishte gjëja më e mirë që bëri, na mori nga atje, na solli në Tiranë dhe na mbajti në shtëpinë e tij. Jetonim në shtëpinë e tij të vogël, të tërë në një dhomë me një banjë që ishte pa asnjë instalim hidrosanitar. Kemi jetuar aty 10 veta me fëmijë të vegjël, ishin dy binjakë dhe me nënën e Halitit që ka qenë një zonjë e mrekullueshme. Ka qenë nga familja e Karagjozëve, një zonjë e mrekullueshme.




Libra të përkthyer nga Halit Selfo

**-Problemet tuaja në biografi, ishin për shkak të mbiemrit Omari?**

Unë kam vuajtur sigurisht edhe nga Frashëri edhe nga Omari. Ishte e pamundur që të merrja punën që më takonte. Për arsye ekonomike ndërpreva shkollën dhe pasi hyra në punë si punëtore e thjeshtë, bëra shkollë nate, ekonomikun. Nuk punova dot asnjëherë më shkollën e ekonomikut, sepse kudo që shkoja më dilte vula e zezë.

**-Edhe vetë Haliti kishte problemet e veta me regjimin, për shkak të vëllait që ishte pushkatuar. Çfarë dini ju për këto probleme?**

Shumë probleme kishte. Haliti kishte gjashtë vëllezër, e ai vetë i shtati. Nga këta unë kam gjetur, 6 se njëri, Syrjai, vëllai i gjashtë Halitit, është pushkatuar, duke e nxjerrë nga qelia pas shumë torturash, pothuaj të vdekur, e kanë pushkatuar. Syrja Selfo ka qenë krahu i djathtë i Enver Hoxhës gjatë luftës. Këta kishin edhe lidhje familjare me Enver Hoxhën, sepse halla e Halitit, ka pas marrë baba Çenen, xhaxhanë e Enverit, ndaj kishin pasur edhe hyrje e dalje familjare.

**-Është ky, që i ka dhënë kostumin e dasmës, Enver Hoxhës?**

Po, ai është. Ndërsa i madhi, Reiz Selfo unë e kam arritur, por, për fat të keq, nuk e njoha se ime motër u martua në 1950-ën ndërsa më 1951 ai u pushkatua në shkurt për çështjen e së ashtuquajturës, bombë në Legatën Jugosllave. Është marrë nga shtëpia me pizhame dhe direkt është pushkatuar. Të gjitha këto Haliti i ka vuajtur shumë, kuptohet. Ndërsa pesë të tjerët kanë vuajtur me kancer, që nga Haliti, Qazimi, Fejziu, Masari dhe Xhevati. Siç e dimë, kanceri është sëmundje që vjen prej stresit.

Kur është pushkatuar Reisi më 26 shkurt, Haliti ka vajtur në mëngjes në zyrë me kravatë të kuqe. Gjithë shokët, i kanë dhënë dorën duke i thënë: mirëmëngjes Halit, sepse nuk mund ta ngushëllonte njeri. Ai kishte shumë dhimbje dhe unë nuk e di, se ku e gjente ai atë forcë, e atë kurajë për të përballuar jetën e për të mbajtur hallet e të gjithëve ne: të familjes së tij e tonës. Mbante, gjithë hallet e Selfove dhe familjeve të grave të tyre, sepse ata ishin martuar me vajza me njolla në biografi. Ishim të gjithë njerëz me vulë në kurriz, disa vulë borgjeze e disa reaksionare. Katër vjeçe isha unë, kur më arrestuan babanë.

**-Me gjithë vdekjet e pushkatimet e familjarëve, me gjithë presionin dhe luftën e klasave, Halit Selfo, mes varfërisë e dhimbjes, mundi të përkthente?**

Të përkthente dhe vepra të mëdha e të vështira. Kur ka përkthyer "Kontin e Monte Kristos" ka pasur katër tumore në kokë. Nuk ia dinim sigurisht, por ai çmendej nga dhimbja kokës, edhe ne thoshim pse i dhemb koka aq shumë. Atëherë nuk kishte as skaner, e as ezhe. Derisa vdiq ne nuk e dinim mirë çfarë kishte. I mësuam katër tumoret, nga autopsia. Doktor Nikolla Dushniku, ia diktoi kancerin, por qe e vështirë të mbijetonte.

**-A fliste ai për dhimbjen e tij në shtëpi, për vëllezërit që iu pushkatuan?**

Jo, nuk fliste ai në shtëpi për këtë. Unë kam qenë shumë e re sigurisht dhe me mua nuk mund të fliste për këtë. Fëmijët ishin të vegjël dhe ishte frika që na mbante, na tkurrte. Unë vetëm kur kam qenë e vogël, kur më thoshin kë do më shumë: babanë tënd a Enver Hoxhën-doja të thosha që doja babanë, por kisha frikë dhe thosha dua Enver Hoxhën. Shtrydhesha që të thosha babanë, por më thoshin se duhet të duash Enverin dhe thosha "Enverin dua". Ki parasysh se në çfarë presioni jetonim ne. edhe kur erdhëm në Tiranë, Haliti nuk fliste me ne kurrë, mbase me time motër, me të shoqen, po, por jo me ne.

**-Ju e keni ndihmuar atë për përkthimin. Çfarë bënit konkretisht? Daktilografonit?**

Ai përkthente me shkrim dore, ndërsa unë ia diktoja daktilografit. Dhe nga daktilografi, unë i merrja dhe me fjalor përpara bëja korrigjimet, korrektimet. I bëja me fjalor, se po të mos kisha fjalor në dorë, nuk më linte. Por ai kishte besim te unë se unë kam qenë nxënëse e shkëlqyer. Më linte pa frikë ta ndihmoja.

Urdhri: Të hapet njësia për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit

# 'Luarasi', MASR miraton çeljen e fakultetit të ri për 2018-2019

## Ja 3 departamentet që do të ofrohen për studentët

Voltiza Duro

Kolegji Universitar "Luarasi" do të çelë Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit për vitin e ri akademik 2018-2019. Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, nëpërmjet një urdhri të firmosur nga ministrja Lindita Nikolla, ka miratuar licencimin e hapjes së kësaj njësie kryesore duke i shtuar "Luarasit", studimet në fushën e teknologjisë për të gjithë të rinjtë e interesuar. Sipas urdhrit nr. 266, Kolegjit Universitar "Luarasi" i jepet e drejta e çeljes së fakultetit të ri, respektivisht në Departamentin e Informatikës Ekonomike, Departamentin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit si dhe në Departamentin e Matematikës dhe Statistikës. Pra, këto janë tri departamentet e reja mbi të cilat do të shtrihen fushat e studimit në degët e kërkuara më së shumti nga tregu i sotëm. "Veprimtaria akademike në njësinë kryesore "Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit" të Kolegjit Universitar "Luarasi", fillon në vitin






Faksimile e vendimit të MASR

akademik 2018-2019. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Kolegji Universitar Luarasi",-theksohet në urdhrin e hyrë në fuqi më datën 14 maj të këtij viti.

**FAKULTETI I RI**

Hapja e fakultetit më te ri të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit është një nga risitë më të fundit duke iu përshtatur me programet e tij kërkesave dhe nevojave të shoqërisë dhe tregut të punës, pasi pajisja me njohuritë më të fundit mbi ICT tashmë është bërë jetësore për të gjithë. Gjithçka po shkon drejt globalizimit dhe dixhitalizimit. Ky fakultet do të ofrojë programe në bachelor mbi sigurinë kibernetike dhe informacionit si dhe master profesional dhe shkencor. E veçanta e programeve është se mund të studiojnë edhe studentë me njohuri dhe eksperienca nga fusha të ndryshme.



## Bullgaria në mbështetje të Ballkanit Perëndmior, Fibank është banka më e madhe me kapital 100% bullgar.

Presidenca Bullgare përshëndeti angazhimin e përbashkët të partnerëve të Ballkanit Perëndimor në vlerat dhe parimet evropiane si dhe në vizionin e një Evrope të fortë, të qëndrueshme dhe të bashkuar, të mbështetur nga lidhjet tona historike, kulturore dhe gjeografike dhe nga interesat tona të përbashkëta politike, të sigurisë dhe ekonomisë. Qëllimi kryesor i këtij samiti është mbështetja për një perspektivë europiane për Ballkanin Perëndimor nga ku BE është e vendosur të forcojë dhe intensifikojë angazhimin e saj në të gjitha nivelet për të mbështetur transformimin politik, ekonomik dhe shoqëror të ketij rajoni.

Axhenda e prioriteteve të Sofias u fokusua në: zgjerimin e investimeve dypalëshe të donatorëve dhe Institucioneve Financiare Ndërkombëtare. Rritjen e ndjeshme dhe ofrimin e garancisë të Ballkanit Perëndimor për investitorët private si dhe nisjen e një pakete të konsiderueshme të asistencës teknike për identifikimin e investimeve të mundshme dixhitale (duke përfshirë broadband) përmes investimeve të Ballkanit Perëndimor në lidhje me investimet e Para-Anëtarësimit.




Fibank është banka më e madhe me kapital 100% bullgar dhe si një bankë rajonale që vepron për më shumë se 25 vjet në Bullgari është banka më e zhvilluar në fushën dixhitale. Ajo ka prezantuar versionin Flexcube 12 të kompanisë Oracle, një projekt strategjik për përmirësimin e sistemeve të bankës. Fibank Bullgari ofron aplikacionin mobile më të përparuar si dhe karta krediti të teknologjisë touchless – fituese për kartën dixhitale më të mirë për vitin 2017. Të tilla investime priten të huazohen edhe për Fibank Shqipëri. Kapacitetet njerëzore janë vënë në funksion të zgjerimit të rrjetit dhe ofrimit te produkteve e shërbime inovative për një bankë dinamike me vendimmarrje shumë të shpejtë në produkte e shërbime fleksibël të përshtatura për çdo tip klienti.



Erion Veliaj: Do të aplikohet në të gjitha shkollat

## Laborator modern informatike për nxënësit e "Vasil Shantos"

Të gjitha shkollat e Tiranës do të pajisen me laboratorë modernë për zhvillimin e lëndës së teknologjisë së informacionit. Ky është lajmi i mirë që vjen për nxënësit e kryeqytetit, pas prezantimit të projektit për transformimin e Piramidës në qendrën më të madhe të teknologjisë dhe inovacionit në rajon. Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe ambasadorja e Greqisë në vendin tonë, Eleni Sourani përuruan laboratorin e ri të informatikës në shkollën "Vasil Shanto", i cili përmirëson ndjeshëm mësimdhënien në fushën e IT. "Jam shumë i lumtur që sot po hapim një laborator informatike, që vjen si një investim konkret me 14 kompjuterë për klasën e informatikës në shkollën 'Vasil Shanto'. Unë e di që Tirana ka 226 shkolla, por duke folur për të 226 nuk zgjidhim gjë, ama duke folur për secilën prej tyre e duke bërë çdo ditë nga një punë me miq që dhurojnë diçka konkrete, atëherë mund transformojmë çdo shkollë",-tha Veliaj. Ai shtoi se Bashkia e Tiranës, në bashkëpunim edhe me donatorët, do ta shtrijë projektin e ndërtimit të laboratorëve të informatikës në të gjitha shkollat e qytetit. "Është shumë e rëndësishme që të investojmë edhe në infrastrukturë, por edhe në dhënien e dijeve, sidomos në fushën e teknologjisë së informacionit. Duam që ta vijojmë këtë edhe me donatorë të tjerë, në të gjitha shkollat e Tiranës, për t'i pajisur ato me laboratorë modernë",-u shpreh Veliaj. Një kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e të rinjve për teknologjinë e informacionit do të jetë gjatë edhe transformimi i Piramidës, e cila shumë shpejt do të kthehet në qendrën më të madhe rinore multifunksionale në rajon, duke shërbyer si një hapësirë për shkëmbim idesh e nismash, por edhe një inkubator për bizneset e reja në fushën e ICT dhe komunikimit.



Erion Veliaj me nxënësit e "Vasil Shantos"

BLUE TOOTH
Thashetheme
MADE IN ALBANIA
Nr. 610
SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela ALIAJ - Art Designer: Nevila Samarxhi
E shtunë 19 Maj 2018

# FJORENTINA HALILI:

## Ju tregoj të pathënat e ndarjes nga Olsi



*Së shpejti nuse? Flet ish-banorja e "BB9": Kam marrë shumë propozime. "Mund të jem pjesë e 'Big Brother Vip'"*

# FIKSIMI PAS PALESTRËS

## Nga Aurela Gaçe tek Orinda Huta, ja VIP-at që kanë pasion të dytë sportet







## NJË TJETËR SUKSES, ERA ISTREFIDO TË KËNDOJË HIMNIN E KAMPIONATIT BOTËROR 2018



**Nga Aurela Gaçe tek Orinda Huta, ja figurat e njohura që kanë pasion të dytë sportet**

# VIP-at dhe fiksimi pas palestrës

## *Krosfit, tendenca e fundit e njerëzve të famshëm për të qenë në superformë*

Pamela Aliaj

*Ditët e sotme mund të themi se nuk është vetëm arsyeja e të qenurit "in" apo në superformë për të ndjekur një palestër apo një sport të caktuar. Shumë prej njerëzve i ndjekin ato për të pasur një trup të shëndetshëm, për arsye mjekësore, apo edhe për pasion apo antistres. Por një gjë të tillë duket se nuk e shohim tek të gjithë VIP-at tanë. Është mëse e dukshme se "sporti" më i preferuar i tyre kohët e fundit është krosfit. Disa prej tyre e ndjekin për të pasur një trup sa më të formuar e gati për një verë super të nxehtë, të tjerë e ndjekin sepse është tendenca e fundit e të gjithëve, ndërsa të tjerë e kanë pjesë të pandarë të përditshmërisë së tyre, duke e quajtur ndryshe edhe pasion të tyre. Më poshtë do t'ju listojmë disa nga VIP-at tanë, të cilët kanë zgjedhur krosfitin, palestrën apo edhe sporte të tjera, të cilat i ndjekin në kohën e tyre të lirë. Pasion, tendencë apo thjesht rutinë e detyrueshme, këtë gjykojeni edhe ju.*

### Aurela Gaçe

Përveçse njihet për fuqinë e saj të pashter-ueshme në skenë dhe zërin potent, Aurela është një "fanse" e "çmendur" e palestrës. Nën vëzhgimin e trajnerit të saj personal, këngëtarja nuk harron të jetë aktive edhe në sporte të ndryshme si kikboks. E ku do ta çojë të gjithë atë energji Aurela, duke qenë se nuk do të qëndrojë 24 orë/24 në skenë.






### Bora Zemani

Listës së gjatë të ndjekësve të sportit më të njohur dhe më të ndjekur nga VIP-at, iu bashkua edhe moderatorja e sportit, Bora Zemani. Vetëm një javë më parë Bora filloi të ndjekë rregullisht krosfitin nën mbikëqyrjen e trajnerit të saj. Edhe pse s'ka nevojë për t'u dobësuar për shkak të trupit super në formë, Bora mbase ka dashur vetëm të ketë një trup sa më të tonifikuar për këtë verë.

### Afërdita Dreshaj

Pavarësisht se është e ngarkuar me planet për martesë, ku në fund të qershorit do të kurorëzojë dashurinë e saj me të fejuarin çek, këngëtarja kosovare nuk e lë pas palestrën. Për të pasur një trup gjithnjë në formë dhe të tonifikuar, modelja dhe këngëtarja Afërdita Dreshaj frekuenton rregullisht palestrën së bashku me bashkëshortin e ardhshëm.






### Rudina Dembacaj

Krosfit dhe vetëm krosfit. Një tjetër ndjekëse e devotshme e këtij sporti është edhe aktorja e njohur Rudina Dembacaj. Shumë vullnet dhe dëshirë për të pasur një trup të shëndetshëm e bëjnë aktoren ta frekuentojë palestrën, duke mos harruar të përditësojë edhe ndjekësit e saj me ushtrimet që bën aty.

## Orinda Huta

Kjo verë do të jetë vërtetë e nxehtë, por VIP-at tanë nuk duan t'ia dinë. Bukuroshja bionde, Orinda është një tjetër krosfit-dashëse. E pse të mos ketë një trup të tonifikuar pas takimeve të herëpashershme në palestër? Një tjetër trup superseksi do të jetë ai i Orindës, që do t'i shtohet listës së VIP-ave në plazh për këtë verë.





## Irena Kita

Ajo njihet jo vetëm si një frymëzim për shijen e hollë që ka në veshjet e saj dhe stilin që shfaq si blogere në "Instagram", por gjithashtu një pasion i saj i hershëm është edhe tenisi. Irena Kita është një ndër femrat shqiptare, e cila është e dashuruar me këtë sport dhe kjo vihet re edhe tek vajza e saj, e cila e ka trashëguar këtë pasion. Çdo verë vjen me një trup super të tonifikuar, edhe këtë s'ka si të jetë ndryshe për Irenën.



## Dafina Zeqiri

Mund të themi me plot gojë që këngëtarja e njohur kosovare është e "fiksuar" pas palestrës. Kjo vihet re shumë lehtë nga format superseksi të këngëtares nga Kosova. Ajo dallon jo vetëm për pasionin e madh që ka për muzikën, tatuazhet, por edhe për palestrën. Çdo postim i Dafinës është superprovokues dhe shumë sensual. Një vullnet i hekurt, i cili është kthyer në pasion ndaj palestrës, i kanë dhënë këngëtares një trup shumë seksi.

## Linda Halimi

Dhe e fundit e listës, por jo më pak e rëndësishmja, është këngëtarja e njohur Linda Halimi, e cila bëri bujë me shndërrimin e saj drastik të trupit në forma bombastike. Një tjetër rezultat i vullnetit të hekurt dhe mbështetjes së partnerit të saj, i dhanë asaj një trup që ditët e sotme të gjithë e kanë zili. Forma bombastike, të cilat këngëtarja nuk harron t'i shfaqë para kamerës dhe nëpër rrjete sociale, të gjitha janë falë një diete shumë strikte dhe ushtrimeve të rregullta në palestër. Shembull për t'u ndjekur!





## Ilda Bejleri

Dhe radha shtohet gjithnjë e më shumë! Krosfit e asgjë me shumë! Bukuroshja e "Supersport", Ilda Bejleri, është një tjetër ndjekëse e këtij lloj sporti, të cilin ajo ka zgjedhur për të pasur një trup sa më seksi për verën e këtij viti. Mbase jo vetëm kaq, mbase nuk është qëllimi vetëm sa ta kalojë vera për ta ndjekur këtë sport. Le të shohim sa do të zgjasë pasioni i saj.

## Pardje festoi ditëlindjen, por sot Marina surprizon me postimin

Vetëm para dy ditësh moderatorja e njohur, Marina Vjollca ka festuar ditëlindjen. Ajo është mbushur me urime dhe dhurata jo vetëm nga njerëzit e dashur, por edhe nga ndjekësit në rrjete sociale. Vjollca ka publikuar një foto, ku shfaqet e rrethuar nga lulet dhe dhuratat që ka marrë. "Ndihem e bekuar nga dashuria që më dhuruat me urimet tuaja! Faleminderit! Ju dua!", -përfundon Marina, duke u shfaqur më e qeshur se kurrë.



## Një nënë e devotshme si Zaimina i emocionon të gjithë me videon e vajzës

Këngëtarja bukuroshe që tashmë është bërë nënë, Zaimina Vajsari, po kalon ditë mjaft të bukura në shoqërinë e vogëlushes së saj Khloe. Ditën e sotme Zai ka publikuar në rrjete sociale një video ku e vogla është duke i shtrënguar dorën dhe krahas këtij imazhi mjaft të ëmbël ajo shkruan: "Shtrëngimi i dorës më i bukur në jetë", -ka shkruar këngëtarja. Në këtë video të shkurtër të saj arrijmë të shohim pak nga tiparet e vogëlushes.






"Për momentin jam shumë mirë. Si dihet dhe për sa kohë, por jam mirë. Po merrem me diçka timen që s'dua ta zbuloj, sepse të flasësh para kohe thonë të ecën dhe ters"







Së shpejti nuse? Flet ish-banorja e "BB9": Kam marrë shumë propozime

# FJORENTINA HALILI: Ju tregoj të pathënat e ndarjes nga Olsi

## "Mund të jem pjesë e 'Big Brother Vip'"

*Një ndër personazhet më të lakuar të mediasrozë janë padyshim edhe ish-banorët e shtëpisë më të famshme të Shqipërisë, siç është "Big Brother". Të gjithë e mbajmë mend një ndër çiftet më të përfolur gjatë shfaqjes, por edhe pas daljes së tyre, e cila bëri bujë me ndarjen e tyre. Po flasim pikërisht për çiftin Fjorentina e Olsi që tashmë janë të ndarë prej kohësh dhe secili ka nisur jetën e tij tashmë jashtë shtëpisë dhe telekamerave. Kësaj radhe pjesë e fokusit tonë ka qenë Fjorentina Halili, e cila nëpërmjet një interviste ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" ka folur për të vërtetën e fotos ku ajo kishte dalë nuse, projektet që pritet të nisin së shpejti si dhe të vërtetën e pazbuluar të ndarjes së bujshme nga Olsi Klosi.*

Pamela Aliaj

**Prej më tepër se një vit jeni jashtë shtëpisë së "Big Brother". Me çfarë merret tani Fjori?**

Akoma punoj në Top Channel. Pas pune mundohem të merrem me veten, me familjen dhe nipin tim që e kam gjënë më të shtrenjtë në botë, në fund vjen dhe shoqëria, siç mund ta keni parë dhe vetë jetën e natës që unë bëj me ta. (qesh)








# Jon Gjebrea feston ditëlindjen, ja si e urojnë Arditi dhe Merlin

Ditën e djeshme djali i kantautorit dhe moderatorit Ardit Gjebrea, Joni festoi ditën e lindjes. Nuk kanë munguar në rrjete sociale urimet nga Arditi si dhe nga e fejuara e Jonit, Merlin. Ardit Gjebrea ka publikuar një tortë, në të cilën ndodhet portreti i të pestë anëtarëve të familjes. Ndërkohë Merlin i ka bërë Jonit një dedikim mjaft të ëmbël dashurie ku shkruan: "Gëzuar ditëlindjen mashkullit që kam gjithnjë në zemrën time. Të dua", - përfundon Merlin. Ndërsa Joni vetë ka publikuar një foto kur ishte i vogël, duke u bërë kështu nostalgjik në ditën e tij të lindjes.






**A është dikush në jetën e Fjorit? A ju ka propozuar ende?**
Të them të drejtën, ka shumë që më shkruajnë dhe më propozojnë, por varet sa më pëlqejnë mua (qesh). Dikur kam thënë që kam dikë në jetën time, por asgjë zyrtare, thjesht jemi dy shokë akoma shumë të mirë që mua më bën të ndihem mirë, por asgjë konkrete.

**Nëpër portale qarkullonte një foto ku ju kishit dalë nuse. Ndonjë plan së shpejti?**
Ajo është një foto e bërë nga interneti të cilën unë e bëra për humor. Nuk e dija që do bëhej kaq e madhe, e unë pastaj vazhdova lojën me mikun tim shumë të mirë, Xhani Demika.

**Përveç punës që keni në Top Channel, a jeni duke punuar për diçka tjetër? Ju ka propozuar dikush të jeni pjesë e ndonjë projekti?**
Për momentin jam shumë mirë. Si dihet dhe për sa kohë, por jam mirë. Po merrem me diçka timen që s'dua ta zbuloj, sepse të flasësh para kohe thonë të ecën dhe ters. (Qesh)

**Së shpejti pëshpëritet se do të nisë "Big Brother Vip". A do të jeni pjesë e tij?**
Po kam dëgjuar dhe unë, por asgjë konkrete për momentin. A do jem dhe unë pjesë? (Qesh) S'e di të shohim çfarë do të ndodhë.











**Cili është pasioni më i madh i Fjorentinës përveç make-up artist?**
Përveç punës që bëj, kam shumë pasion të kërcej. Dikur e vogël kam pas kërcyer shumë.

**Çfarë ju ka bezdisur më tepër nga thashethemet e mediave rozë? Si keni reaguar?**
Të them të drejtën, asgjë. Unë qesh me ato që shkruhet për mua dhe s'ia u vë re shumë, sepse kuptoj që dhe ata duan të ushqehen duke bërë të tilla lajme.

**Cila është ajo e vërtetë për Fjorin që të gjithë në portale e shtrembërojnë dhe do të donit ta theksonit dhe një herë?**
E vërteta e ndarjes time nga Olsi Klosi që sipas tyre më la, e lashë, më tradhtoi, e të tjerë, e të tjerë; asgjë s'është siç shkruhet nëpër portale. Unë dhe Olsi kishim arsyet tona që vendosëm të dy të mos ishim më bashkë, pastaj dhe karakteret e forta që kemi na bën të pamundur të ishim me njëri-tjetrin, dhe shumë gjera të tjera. Megjithatë unë i uroj vetëm të mira në jetë.

## Moderatorja dhe aktorja, së shpejti në një projekt së bashku

Moderatorja simpatike Nevina Shtylla si dhe aktroja bukuroshe Olta Gixhari kanë rezervuar një surprizë për ndjekësit e tyre. Bëhet fjalë për një film të ri që po realizohet. Filmi do të titullohet "Love" dhe është në bashkëpunim me "Papadhimitri Production". Këtë e kemi kuptuar nga vetë vajzat, të cilat kanë publikuar momente nga xhirimet e filmit dhe duken shumë të lumtura për pjesëmarrjen. Se çfarë roli do luajnë, me shumë mundësi do të mbetet një surprizë derisa të mbarojë xhirimi.











## Një tjetër sukses, Era Istrefi do të këndojë himnin e Kampionatit Botëror 2018

Ajo është padyshim një nga artistet shqiptare, suksesi i së cilës i ka kapërcyer kufijtë e Shqipërisë. Pas performacave të saj në Dubai, emri i Erës do të përmendet në një nga eventet më të rëndësishëm sportiv, Kampionati Botëror i Futbollit 2018. Sipas "Prive.al", Era do të këndojë himnin e këtij eventi në bashkëpunim me këngëtarin dhe aktorin e njohur Will Smith. Sipas burimeve, mësohet se producent i këtij projekti është Dj Deeplo dhe xhirimet e spotit do të fillojnë ditën e nesërme. Era Istrefi do të renditet midis emrave me famë botërore si Jennifer Lopez, Shakira, Anastacia e Jason Derulo, të cilët kanë provuar të njëjtën eksperiencë. Kampionati Botëror i Futbollit këtë vit do zhvillohet nga datat 14 qershor deri me 15 korrik në Rusi, duke mbledhur me miliarda shikues në të gjithë botën.

## Një histori prekëse, fansja e Rita Orës përlot publikun

Këngëtarja shqiptare me famë botërore, Rita Ora, tanimë numëron fansa të shumtë nga të gjitha vendet e botës. Por njëra prej tyre ka arritur që me historinë e saj të prekë zemrat e të gjithëve. Rita ka postuar në "Instagram" një foto të sajën me fansen, duke treguar shkurt historinë e saj. Fansja kishte qenë e paralizuar kur e kishte takuar për herë të parë këngëtaren dhe i kishte premtuar se kur do të takoheshin sërish, ajo do të ishte ngritur në këmbë. Ato ishin ritakuar së fundmi, 5 vite pas takimit të parë dhe fansja kishte ecur 6 hapa për të përqafuar Ritën.








## Së shpejti nënë, Adelina Tahiri merr një superdhuratë nga partneri milioner

Ndërsa është duke shijuar ditët e fundit të shtatzënisë, Adelina Tahiri po poston herë pas here edhe surprizat që bashkëshorti i saj i bën. Ky i fundit po e "çmend" me blerjet dhe dhuratat e shtrenjta mamanë e re të "showbiz"-it shqiptar, gjë të cilën ajo e ka dëshmuar përmes postimeve të ndryshme në rrjetet sociale. Kështu, ditën e sotme Adelina Tahiri e ka nisur ndryshe. Ajo ka vendosur të udhëtojë me makinën e re, me të cilën ka bërë një foto të cilën e ka postuar në "Instagram". Në të shkruan: "Bebushja ime e re. Në dashuri me të". Nga foto, ne nuk mundemi të shquajmë markën e makinës, por kuptojmë se bëhet fjalë për një blerje superluksoze. Me gjasë, kjo është dhurata e radhës nga partneri i saj milioner, avokati i njohur Serjoza Markov.

Zbardhet formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e dosjes

# Pronarët në Fier, ATP merr në shqyrtim 1030 dosje

## Rifreskohet lisa, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 1030 dosje ish- pronarësh që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuesit janë në qarkun e Fierit dhe janë në pritje të vendimit të ATP-së. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit. Të gjithë ish-pronarët që kanë aplikuar për kthimin dhe kompensim pronë në Agjencinë e Trajtimit të Pronave dhe nuk janë njohur ende me vendimin e agjencisë mund të kërkojnë informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhet dosja. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka në dispozicionin të pronarëve formularin -tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në agjenci për të njohur me fazën në cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia e Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës të ktheje përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së dokumentacionin, kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në agjenci. Më pas kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon i dërgon të gjitha kërkesat e ardhura Drejtorit të Përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sektorit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas sektori përkatës përgatitë informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën me kthimin të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI**

- Formulari tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish KKP/AKKP(nëse ka)
- Dokumente te tjerë

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për formacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tre seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjeneralitet dhe adresën dhe jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe ne seksionin e fundit janë të specifikuara pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.


FORMULAR APLIKIMI
INFORMIM NË LIDHJE ME ECURINË E DOSJES
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:
Tel: (+355) 42 22 56 831 / 38
E-mail: info.atp@atp.gov.al
Web: www.atp.gov.al

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

Shënim: ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN
1. Emri
2. Mbiemri
3. Emri i Babait
4. NID
5. Gjinia Mashkull Femër
6. Datëlindja
7. Vendlindja
8. Shtetësia
9. Adresa
10. Qyteti
11. Rrethi
12. Kodi Postar
13. E-mail
14. Nr. Tel. Celular
15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN
16. Kërkoj informacion për:
Dosjen nr.
Emri i subjektit të shpronësuar
Qarku
17. Kërkoj kopje të vendimit

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR
Kërkesa sipas formatit i cili gjendet pranë zyrës së marrëdhënieve me publikun
Fotokopje të kartës së identitetit
Kopje vendimi nga ish KKKP/AKKP (nëse ka)
Dokumente të tjera

Nënshkrimi i Aplikantit

KLAUZOLA DEKLARATIVE
Unë i/e nënshkruari/a ______ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i Aplikantit

## 1030 DOSJE NË SHQYRTIM

| Nr | Date | Qarku | Statusi | Zona Kadastrale |
|---|---|---|---|---|
| 35 | 10/13/1993 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 346 | 2/20/2016 | Fier | Ne shqyrtim | 1555 |
| 5 | 11/2/1993 | Fier | Ne shqyrtim | 1945 |
| 127/2783 | 12/9/1993 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 872 | 12/9/1993 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 10 | 1/10/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 632 | 1/12/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 1065 | 1/15/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 229 | 2/7/1994 | | Ne shqyrtim | L.Kongresi I Lushnjes |
| 8 | 3/15/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1091 |
| 251 | 3/18/1994 | Fier | Ne shqyrtim | bel-ishov |
| 7--6 | 3/29/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 792 | 4/5/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 400 | 6/22/1905 | Fier | Ne shqyrtim | 2342 |
| 161 | 4/20/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 2265 |
| 412 | 6/22/1905 | Fier | Ne shqyrtim | 1827 / 3503 |
| 17 | 4/22/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 26 | 5/17/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 58 | 5/20/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 173 | 7/5/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 181 | 7/21/1994 | | Ne shqyrtim | Ra-dostine |
| 47 | 7/27/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1857 |
| 33 | 8/4/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1090 |
| 587 | 8/9/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 8531 |
| 562 | 8/13/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 3981 |
| 583 | 8/16/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 8532 |
| 70 | 8/18/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 250 | 8/19/1994 | Fier | Ne shqyrtim | hekal |
| 17/16 | 8/26/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 590 | 8/29/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1001 |
| 129 | 8/29/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 2497 |
| 22/21 | 8/29/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 490 | 1/20/2016 | Fier | Ne shqyrtim | 2160 |
| 23/22 | 8/29/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 595 | 8/30/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 8531 |
| 25/24 | 8/30/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 3172 |
| 312 | 8/31/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 226 | 8/31/1994 | | Ne shqyrtim | ? |
| 27/26 | 8/31/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 3172 |
| 33/31 | 9/5/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 2594 |
| 193 | 9/25/1994 | | Ne shqyrtim | Fshati Dushk |
| 56 | 9/29/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 2160 |
| 31 | 10/12/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 75 | 11/14/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1492 |
| 41 | 11/15/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1090 |
| 12 | 11/17/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1090 |
| 36 | 11/25/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1567 |
| 80 | 11/29/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 2384 |
| 517 | 12/13/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1492 |
| 21 | 12/13/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 3983 |
| 33 | 12/13/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 1975 |
| 122 | 12/22/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 3015 |
| 524 | 6/22/1905 | Fier | Ne shqyrtim | 2289 |
| 525 | 1/20/2016 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 171 | 12/28/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 594 | 12/29/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 3981 |
| 51 | 12/29/1994 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 590 | 12/30/1994 | Fier | Ne shqyrtim | 3980 |
| 5 | 1/5/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 2108 |
| 16 | 1/9/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1422 |
| 2 | 1/13/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1090 |
| 3 | 1/13/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 2869 |
| 7 | 1/13/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1422 |
| 101 | 1/23/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1135 |
| 117 | 2/3/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1539 |
| 46 | 2/16/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1422 |
| 126 | 2/20/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1945 |
| 13 | 2/21/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1090 |
| 81 | 2/27/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1492 |
| 166 | 3/1/1995 | | Ne shqyrtim | Mallakaster |
| 138 | 3/14/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 8574 |
| 47 | 3/18/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1295 |
| 3 | 3/25/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 2527 |
| 133 | 4/1/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1143 |
| 136 | 4/13/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1401 |
| 707 | 4/20/1995 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 138 | 4/21/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1566 |
| 30 | 5/28/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1438 |
| 162 | 5/29/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1762 |
| 141 | 6/1/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 2436 |
| 143 | 6/1/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 2802 |
| 202 | 6/15/1995 | | Ne shqyrtim | Gjebras |
| 146 | 6/16/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 2802 |
| 240 | 6/30/1995 | | Ne shqyrtim | Ngracan |
| 150 | 7/4/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 2384 |
| 203 | 7/26/1995 | | Ne shqyrtim | Bardhaj |
| 162 | 8/3/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 8572 |
| 156 | 8/4/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 3191 |
| 159 | 8/10/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 2350 |
| 29 | 8/29/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1945 |
| 170 | 9/15/1995 | | Ne shqyrtim | Fshati Bejar |
| 469 | 10/22/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1811 |
| 182 | 10/23/1995 | | Ne shqyrtim | Ballsh |
| 181 | 10/29/1995 | | Ne shqyrtim | Ballsh |
| 152 | 11/3/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1033 |
| 10 | 11/6/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1857 |
| 8 | 11/8/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1422 |
| 188 | 11/29/1995 | | Ne shqyrtim | Hekal |
| 166 | 12/1/1995 | | Ne shqyrtim | Fshati Senes Lushnje |
| 466 | 12/8/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 2497 |
| 499 | 12/11/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 1414 |
| 3 | 12/12/1995 | Fier | Ne shqyrtim | 3508 |
| 193 | 12/22/1995 | | Ne shqyrtim | Romes Mallakaster |
| 194 | 12/22/1995 | | Ne shqyrtim | Romes Mallakaster |
| 744 | 1/5/1996 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 94 | 1/21/1996 | Fier | Ne shqyrtim | sarave |
| 195 | 1/23/1996 | | Ne shqyrtim | Romes Mallakaster |
| 48 | 6/20/1905 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 470 | 2/8/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 325 | 2/20/1996 | Fier | Ne shqyrtim | qend-er |
| 215 | 2/21/1996 | | Ne shqyrtim | fratar |
| 200 | 2/27/1996 | | Ne shqyrtim | Symize |
| 487 | 2/29/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1609 |
| 490 | 3/6/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 3713 |
| 5 | 3/11/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 8571 |
| 493 | 3/13/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1414 |
| 40 | 3/20/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1567 |
| 82 | 3/20/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1582 |
| 208 | 3/24/1996 | | Ne shqyrtim | Drenove |
| 752 | 4/3/1996 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 115 | 4/5/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2443 |
| 52 | 4/12/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1135 |
| 253 | 4/17/1996 | Fier | Ne shqyrtim | drenov |
| 33 | 4/22/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 3208 |
| 510 | 4/30/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 3767 |
| 54 | 5/2/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1857 |
| 56 | 5/7/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2076 |
| 50 / 408 | 2.06.2007 | Fier | Ne shqyrtim | 3503 / 1827 |
| 58 | 5/10/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2270 |
| 59 | 5/17/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2869 |
| 568 | 5/22/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1874 |
| 504 | 6/3/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 3000 |
| 520 | 6/3/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2934 |
| 322 | 6/17/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2350 |
| 70 | 6/26/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1090 |
| 90 | 6/27/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2350 |
| 862 | 6/27/1996 | Fier | Ne shqyrtim | |
| 584 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 3457 |
| 592 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 3537 |
| 100 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2787 |
| 104 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2384 |
| 109 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2104 |
| 110 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2787 |
| 113 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1422 |
| 122 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 1680 |
| 124 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2384 |
| 126 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 3436 |
| 1662 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2038 |
| 130 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | 2160 |
| 125 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | sektor gjelber |
| 179 | 6/28/1996 | | Ne shqyrtim | Aranitas |
| 200 | 6/28/1996 | | Ne shqyrtim | Ngracan |
| 207 | 6/28/1996 | | Ne shqyrtim | Greshice |
| 208 | 6/28/1996 | | Ne shqyrtim | |
| 1087 | 6/28/1996 | Fier | Ne shqyrtim | |

Opinioni i Ditës

Nga: Raimonda Shundi (Dervishi)

# Seks i dobët apo i fortë?

(vijon nga faqja 1)



.... gjithmonë. Gjithçka që ti i jep një gruaje, ajo e përmirëson. Nëse i fal spermën, ajo të dhuron një fëmijë. Nëse i jep një banesë, ajo krijon shtëpinë. Nëse i sjell ushqim, ajo të përgatit një vakt. Nëse i jep një buzëqeshje, ajo të dhuron zemrën. Gruaja shumëfishon dhe përmirëson dhuratat që merr. Ndaj, nëse e trajton si plehrë, përgatitu ta marrësh me tonelata.

Shqipëria jonë, vendi ku lajmi nuk përbën lajm, devijon keqas "ushqimin e çdoditshëm mediatik" - dhunën ndaj gruas dhe fëmijëve. Në fakt, dhuna ndaj gjithçkaje është realiteti i kudogjendshëm në vendin tonë të vogël në kilometra, por gjigant në probleme dhe rreziqet për zgjidhje. Teksa hasesh me kronikat e vrasjeve, përdhunimit, abuzimit apo masakrimit të viktimave të radhës, automatikisht lind pyetja se si mund të dilet nga ky tunel. Emra të pafund rastesh dhe moshash të kalojnë frikshëm në albumin tënd arkiv dhe thua me cilin të nis për ta ditur se çfarë fundi ka ai sot? Çfarë ndodh me fëmijën që abuzoi pedofili Ardian Prenjasi, shoferi i një kompanie pastrimi në zonën e Laprakës, pasi masakroi deri me vdekje 11-vjeçarin Julian Çela? Çfarë bëhet me rastin e Adelajdës, Nazimesë, Edvirës, Valit (mjafton të shkosh në burgun 325). Çfarë ndodh me jetët e tyre të gjymtuara, fshehur në terrin e moralit "gojëmbyllur" shqiptar? Shifrat e viktimave rriten frikshëm si një makinë bastesh me kuaj. Pyetje pa përgjigjen që unë do të doja. Jemi të dënuar me heshtjen që kaosi ynë burokratik shigjeton viktimën e radhës, ndërkohë ne presim kronikën e radhës. Le t'i kthehemi së shkuarës tonë për të diagnostikuar shkakun e gjithë kësaj situate. Natyrisht kudo vriten gra, fëmijë, të moshuar apo abuzohet me qeniet më të dobëta, nëse ata fatkeqësisht janë në vendin apo me personat e gabuar në një shtet me rregulla të qarta loje, por statistikat tona janë të frikshme kur mendon: çfarë ndodh pas një abuzimi? Kush kujdeset, cilët kontaktohen dhe sa zgjidhje u jepet viktimave, që kryesisht janë vetë ishbashkëshortët? Një sistem i sëmurë pothuaj in-ekzistent, duke na u shitur si produktiv me kronikat falënderuese të Organizatave të Kombeve të Bashkuara (të cilat i falënderojmë), ndërkohë që viktimat janë të zbuluara në vendin ku krimi po kryet. Pa strehëza, pa asnjë alternativë përkrahëse, një vend që ofron asgjë. Asgjëja çdo ditë rrit asgjënë e qelbëzuar, duke gangrenizuar çdo qelizë që gjallon. Shkaku është ky realitet që ne jetojmë. Fëmijë të braktisur, vajza të trafikuara, burra që janë tronditur nga familje të gjymtuara, femra të cilat kërkojnë ndihmë… po kujt? Dihet shkaku i gjithë kësaj keqësie. Niveli i ulët i arsimimit, qytetarisë, emocional, varfërisë, xhelozisë, uni, problemet e sistemit tonë mendor… I pari është absolutisht arsimimi.

Malala Yosafzai, 17-vjeçarja pakistaneze, (nobeliste) thotë se "për të luftuar analfabetizmin, varfërinë e terrorizmin, duhet të përqafojmë librat dhe lapsin. Janë armët më të fuqishme. Një fëmijë, një mësues, një libër dhe një laps, mund të ndryshojnë botën".

Nëse nis të kërkosh në faqet e "Google" dhe vendos të marrësh informacione mbi vrasje, viktima, kronika të zeza… lajmet janë kaq të shumta saqë nuk di se me cilin rast të nisësh kërkimin. Kronikat imtësuese janë gati t'u hidhen edhe filmave, dramturgjisë, deri të historitë e rrëfyeshme për fëmijë. Dhuna na sofistikohet artistikisht, duke pjellë kurreshti deri imitim të mendjeve të sëmura. Memorja nis të më kujtojë të famshmin "Kod ligjor të Lek Dukagjinit, Kanunin" libri më i përfolur autentik shqiptar, i cili ende ka fanatikët e tij që vazhdojnë ta ndjekin megjithëse janë të evoluar me kollare e kostume. Shekujt fluturojnë dhe qenia njerëzore sofistikohet apo zhvillohet, ndërsa dhuna fle aty tek një skutë e fshehtë jona dhe varet nga ne se cilën ushqejmë. Duke qenë të tillë si qenie njerëzorë, duhet të mendojmë strategjitë mbrojtëse, ligjet. Pa ligje s'ka caqe. Kanuni pati ligjet dhe ndjekësit e tij. Në ligjet për të drejtat e familjen, specifikohen kufijtë sipas përkatësisë gjinore, burrit dhe gruas. Nëse i referohemi dramaturgjisë sonë, ka disa vepra ku ky fenomen është pasqyruar. Drama "fisheku në pajë" e Fadil Krajës sjell në vëmendje fishekun e dhënë nga vet babai për dhëndrin në rastin kur vajza e tij nuk është në lartësinë e duhur, për t'u ekzekutuar nga ky i fundit. Dhe Kanuni e saktëson qartë se nëse vajza bën "zhibla" dhe nuk i rri nën sundim burrit… ajo ndëshkohet.

"Nëse nuk je ashtu siç Kanuni edukon, ndëshkimi është çështje kohe", po sot?!

Detyrët e burrit ndaj grues:

a) Me u përkujdesë për veshë e mbathë e për gjithshka të lypet për me mbajt jetën.

b) Me e ruejtë nderën e grues e mos me e lanë me u ankue për kurrnji nevojë.

Detyrët e grues ndaj burrin:

a) Me ia ruejtë nderin burrit.

b) Me i rrogue pa zhibla.

c) Me i ndejt nënë sundim.

d) M'u përgjegjë detyrave të kunorës.

e) Me rritë e me mkambë fmin me nderë.

f) Me i ndejë gadi me të veshmen e të bathmen (kah e qepmja).

g) Mos me i u përzie në fejes të të bijave e bijve.

Deri në ditët tona, gjyqtarja Fildes Hafizi e shumë të tjera, gra që "Kanuni" i vrau. Ajo, gruaja, i lindi, u kujdes, i rriti, edukoi, i fali kënaqësi, familje, vëmendje dhe ai e vrau, dhunoi e masakroi duke krijuar tragjedinë zinxhir në familje te fëmijët që kanë parë dhunën. Ata vazhdojnë t'i masakrojnë çdo ditë, megjithëse Kanuni i kishte të saktësuar qartë të drejtat e burrave dhe grave. Sot ky Kanuni ynë sa i qartë është?

Si na shohin

Në janar 2003, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) në rekomandimet përmbyllëse për raportin e kombinuar të parë dhe të dytë periodik

të Shqipërisë dhe nën dritën e Rekomandimeve të Përgjithshme nr. 19, i kërkuan Shqipërisë të

vendoste prioritet të lartë ndaj masave të gjithanshme për adresimin e dhunës ndaj grave në familje dhe shoqëri, si dhe të pranonte se një dhunë e tillë, duke përfshirë dhunën në familje përbën dhunim të të drejtave të grave sipas konventës. Ai i bëri gjithashtu thirrje Shqipërisë të adoptonte ligje mbi dhunën në familje dhe të siguronte se dhuna ndaj grave ndiqet penalisht dhe dënohet me seriozitet dhe shpejtësi. Gratë viktima të dhunës duhet të kenë mjete të menjëhershme për zhdëmtim dhe mbrojtje, duke përfshirë urdhrat mbrojtës dhe akses në ndihmë ligjore. CEDAW gjithashtu rekomandonte se duhet të merren masa për të siguruar një numër të mjaftueshëm strehëzash për gratë viktima të dhunës si dhe të sigurohet që zyrtarët publikë, sidomos zyrtarët e zbatimit të ligjit, gjyqësorit, punonjësit e shëndetësisë dhe punonjësit socialë, janë të sensibilizuar në lidhje me të gjitha format e dhunës ndaj grave. Më tej CEDAW rekomandonte se shteti palë duhet të mbledhë sistematikisht të dhëna në lidhje me dhunën ndaj grave, duke përfshirë dhunën në familje dhe të marrë masa për rritjen e sensibilizimit ndërmjet mediave dhe programeve edukuese për publikun në mënyrë që ta bëjë këtë dhunë shoqërisht dhe moralisht të papranueshme. Së fundmi, CEDAW vinte në dukje shqetësimin e vet në lidhje me "ringjalljen e së drejtës zakonore (Kanunit) dhe kodeve tradicionale të sjelljes në disa zona veriore të vendit" dhe i kërkoi Shqipërisë të "merrte masa për eliminimin e praktikave të së drejtës zakonore dhe të kodeve tradicionale të sjelljes, të cilat diskriminojnë gratë".

Gruaja dhe forca e saj në botë (shembuj)

Përgjatë gjithë botës, shumë gra të forta kanë ndërmarrë fushata për ndryshime në disa nga çështjet me jetësore humane: barazia gjinore dhe raciale, mundësia për të pasur ushqim dhe ujë, integriteti mjedisor, përgjegjshmëria e qeverisë dhe shumë më shumë.

Shpeshherë, ato rrezikojnë jetën e tyre. Kurse gjithmonë kanë të rrezikuar reputacionin, jetesën dhe lirinë.

Në Iran, vajzat shpesh gjuhen me gur deri në vdekje nëse kryejnë marrëdhënie jashtëmartesore, edhe nëse kjo vjen nga përdhunimi.

Asieh Amini mësoi për herë të parë mbi këtë fenomen kur ishte duke reportuar për një gazetë vendëse në Iran, kur dikush i tha se një vajzë 19- vjeçare e quajtur Leila ishte përdhunuar disa herë nga familjarët. Amini u hodh menjëherë në veprim dhe ushtroi presion tek gjyqtari i çështjes për ta liruar vajzën. Që nga ajo kohë, Amini ia ka dedikuar jetën e saj luftimin të kësaj praktike të tmerrshme, edhe pse e përndjekur dhe kërcënuar nga autoritetet. Duke sensibilizuar njerëz nga vendi i saj dhe në botë, Amini ka mundur të shpëtojë jetën e shumë grave. Kërcënimet ndaj saj me kalimin e kohës u bënë aq të rënda, sa ajo u detyrua të largohej nga Irani për të vazhduar punën në Norvegji.

–

India mund të jetë shteti me rritjen më të shpejtë në botë, por shumë njerëz, aq më tepër vajzat, janë duke u lënë mbrapa sepse sistemi shkollor është në dështim. Disa nga problemet e edukimit në Indi përfshijnë: mungesën e theksuar të mësuesve, një nga numrat më të mëdhenj në botë të nxënësve që lënë shkollën dhe mungesa e banjave funksionale dhe të ujit të rrjedhshëm. Rashmi Misra donte ta ndryshonte këtë, kështu që ndërmori vetë hapjen e një shkolle dhe u mundësoi fëmijëve të varfër një edukim rigoroz. Përpjekjet e saj me kalimin e kohës tërhoqën vëmendje ndërkombëtarisht dhe kjo bëri të mundur për hapjen e mëtejshme të shkollave në lagje të varfra të Nju Delhi-t, Mumbai-t, dhe të Goa-s. Sot, "Shkollat Vidia" janë të përqendruara në fuqizimin e vajzave të reja dhe grave, duke i mundësuar edukim falas dhe duke i dhënë aftësi sipërmarrëse. Aktivistët që kërkojnë më shumë përgjegjshmëri dhe liri në Kinë përgjithësisht arrestohen dhe burgosen. Kështu që kur Nanfu Uang filloi të dokumentonte përpjekjet e aktivistëve kundër dhunës seksuale, u ndesh me survejimin e shtetit.

Por, barrierat e reja nuk e pengun Nanfu-n. Ajo iu vu punës për të hedhur dritë mbi një seri rastesh të dhunës seksuale, të cilat po mënjanoheshin duke qenë se figura të rëndësishme lokale ishin të përfshira. Nanfu filloi të përdorte kamera të fshehta për të filmuar pamje dhe me kalimin e kohës u detyrua të largohej nga shteti i saj për të mundësuar publikimin e punëve në një audiencë më të gjerë. Filmi, rezultat i punës së saj, "Hooligan Sparrou" ka marrë famë ndërkombëtare. Bëhet fjalë për një avokat punonjësish seksi, që njihet me emrin Hooligan Sparrou dhe hedh dritë mbi kufizimet e mëdha në të shprehur me të cilat njerëzit në Kinë duhet të përballen.

Gratë janë qytetarë të klasit të dytë në Arabinë Saudite. Numri i kufizimeve që ato duhet të përballen është marramendës. Për Safa al Ahmad, kjo shtypje gjinore është edhe si rrjedhojë e shtypjes së lirisë së fjalës në shoqërinë e tërë. Kur Pranvera Arabe shpërtheu përgjatë gjithë vendit, Arabia Saudite nuk qe e paprekshme ndaj mospajtimeve të brendshme, por qeveria u përpoq dëshpërimisht t'i shtypte protestat. Safa al Ahmad filmoi në mënyrë të jashtëligjshme kryengritjet paqësore në Arabinë Saudite dhe mundi t'i merrte kontrabandë jashtë shtetit për të krijuar "Kryengritjen Sekrete të Arabisë Saudite".

Që nga ajo kohë, Safa al Ahmad ka bërë dokumentarë të tjerë mbi kryengritje në Lindjen e Mesme dhe ka qenë një avokate e palëkundur e të drejtave të grave. Shembujt e këtyre grave na frymëzojnë dhe duhet të na bëjnë të vetëdijshëm për fuqinë që realisht ne gratë kemi. Të drejtat njerëzore janë njësoj për të dy sekset. Ai seks që mendon se është superior, e ka gabim. Gabimet janë njerëzore, prandaj është e nevojshme që të ndreqim gabimet e njëri-tjetrit për hegjemoni.

Dje *në* "Europa e lirë"

# Kacafytjet e fyerjet mes deputetëve dëmtojnë imazhin e Kuvendit

Arton Konushevci

*(vijon nga faqja 1)*

... shoqërisë civile. Debati i ashpër, degradues e ofendues vazhdon të jetë prezent në pothuajse çdo seancë të Kuvendit të Kosovës. Rasti i fundit ishte në seancën e së enjtes, kur kryesuesi i seancës, Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit, ka zhvilluar një debat të ashpër e ofendues me deputetin Arben Gashi nga Lidhja Demokratike e Kosovës, pasi këtij të fundit nuk iu dha e drejta e fjalës për një replikë dhe po ashtu, ka përdorur fjalë fyese. Pasi të enjten kanë shkëmbyer vetëm fjalë, të dy deputetët të premten janë shtyrë edhe fizikisht. Deputeti Haliti në seancën e së premtes ndërsa po votonte për dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, është afruar pranë deputetit Gashi dhe ka pasur shtyrje. Kryetari i Kuvendi të Kosovës, Kadri Veseli, ka kërkuar nga deputetët që të mos bëjnë sjellje të padëshirueshme dhe pahijshme. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ka shprehur shqetësimin dhe indinjatën e thellë lidhur me veprimet e fundit joparlamentare të shfaqura në Kuvendin e Kosovë, gjegjësisht konfrontimet verbale e madje edhe fizike ndërmjet deputetëve Xhavit Haliti dhe Arben Gashi. "Është e papranueshme që deputetët e Kuvendit të fyejnë njëritjetrin dhe të përleshen fizikisht. Për më tepër, dhuna dhe konfrontimet fizike cenojnë rëndë vlerat, të cilat do të duhej t'i përfaqësonte organi më i lartë në vend", thuhet në reagimin e KDI-së. Albert Krasniqi, nga Instituti Demokratik i Kosovës, organizatë kjo që monitoron punën e Kuvendit, thotë për Radion Evropa e Lirë, se vetë deputetët e pranojnë se Kuvendit i ka humbur imazhi që e ka pasur dhe i cili është ndërtuar për vite të tëra. Kjo, sipas Krasniqit, po ndodh edhe për faktin e degradimit të fjalorit të deputetëve. Ai pohon se gjuha degraduese tashmë është shndërruar në gjuhë normale në Kuvend. "Kjo tregon edhe për mungesën e vetë integritetit të këtyre deputetëve, të cilët kanë një fjalor të tillë dhe atë e përdorin në Kuvend, madje edhe në diskutimet e tyre të përditshme. Kjo është gjuha me të cilën shumë prej tyre komunikojnë dhe është vështirë tashmë që ata të komunikojnë me një gjuhë tjetër kur e humbin durimin. Pra, i kthehen asaj çfarë dinë ta bëjnë më së miri dhe jo të arrijnë ta kundërshtojnë me argumente njëri–tjetrin, pikëpamjet e tyre politike", vlerëson Krasniqi. Krasniqi thotë se në bazë të rregullores së Kuvendit të Kosovës, kryesuesit e seancave parlamentare, për deputetët që përdorin gjuhë fyese, mund të marrin masa dhe t'i largojnë nga seanca, por kjo siç thotë ai, nuk po ndodh. "Akoma më keq është kur prej vetë kryesueseve të seancave plenare po ndodh degradimi i fjalorit dhe janë nxitësit e këtyre eskalimeve, siç është zoti Haliti, (Xhavit Haliti) që e kemi parë shumë shpesh në këtë rol kohëve të fundit", thotë Krasniqi. Profesori universitar i Sociologjisë, Shemsi Krasniqi, thotë për Radion Evropa e Lirë se me mënyrën se si komunikojnë deputetët, por edhe politikanët e tjerë, tregon se ata kanë një deficit të kulturës gjuhësore, të komunikimit dhe mirësjelljes. "Këtë deficit ndoshta nuk do ta plotësojnë me ndonjë trajnim ose me ndonjë qortim, apo me ndonjë ndëshkim të eprorëve, por këta do të duhej të ndëshkoheshin nga votuesit nga qytetarët. Kjo duket se po vjen edhe prej një vetëbesimi të tepruar të deputetëve, njëfarë autoritarizmi që kanë krijuar dhe po u duken se janë të pazëvendësueshëm. Mendoj se duhet ta marrin dënimin e merituar nga shoqëria për këtë komunikim, këtë sisoj edhe për këtë gjuhë kaq degraduese që janë duke e përdorur, sepse ata japin edhe shembull të keq në shoqëri", vlerëson Krasniqi. Drejtuesit në organizatat joqeveritare thonë se në vend të ofrimit të argumenteve dhe fakteve në debate të ndryshme, deputetët ofrojnë një fjalor, siç e quajnë ata, të pistë, i cili është i rëndë, fyes dhe ofendues për bashkëbisedusit. Valmir Ismaili, analist nga organizata joqeveritare "Demokracia Plus", thotë për Radion Evropa e Lirë, se Kuvendi i Kosovës është institucioni më i lartë ligjvënës prej të cilit do të duhej të promovohej toleranca, mirësjellja e gjuha demokratike, por në fakt aty po ndodh e kundërta. "Nëse qytetarët e shohin një gjë të tillë duke ndodhur në Kuvendin e Kosovës, atëherë çfarë pritet që të kemi në institucionet e tjera që nuk janë aq relevante sa është Kuvendi i Kosovës?! Prandaj, do të duhej që të kishte masa ndëshkuese për ata që përdorin një gjuhë të tillë, përndryshe reputacioni i Kuvendit të Kosovës do të bie edhe më poshtë", thotë Ismaili. Edhe analistët politikë theksojnë se diskursi dhe sjelljet me të cilat përfaqësues të caktuar të partive politike shërbehen në paraqitje publike, e edhe në Kuvend reflekton mungesën e intelektualizmit në politikë.



"Kjo tregon edhe për mungesën e vetë integritetit të këtyre deputetëve, të cilët kanë një fjalor të tillë dhe atë e përdorin në Kuvend, madje edhe në diskutimet e tyre të përditshme. Kjo është gjuha me të cilën shumë prej tyre komunikojnë dhe është vështirë tashmë që ata të komunikojnë me një gjuhë tjetër kur e humbin durimin. Pra, i kthehen asaj çfarë dinë ta bëjnë më së miri dhe jo të arrijnë ta kundërshtojnë me argumente njëri–tjetrin, pikëpamjet e tyre politike", vlerëson Krasniqi

## HOROSKOPI

### DASHI
Marsi ju dhuron energji për t'ju përkushtuar angazhimeve të përditshme. Ndërsa Urani ju mbështet me ide gjeniale për të lëvizur gjithçka. Do t'ia dilni të nisni një projekt që po e mendoni prej shumë kohësh: rezultatet nuk do të vonojnë.

### DEMI
Me Mërkurin që ju mbështet, thellohuni në gjërat që ju përshtaten dhe ju interesojnë më shumë, dhe do të rrisni kompetencat tuaja profesionale. Mërkuri bashkëpunëtor do t'ju ndihmojë të zgjeroni horizontin dhe të pasuroni lidhjet me të tjerët.

### BINJAKET
Nuk është momenti për të marrë vendime të nxituara: para se të lëvizni, mendohuni mirë! Druajtja se mos dilni keq, për fat, do t'ju shpëtojë! Ndikimi i Mërkurit do të bëjë që të jeni jo të qetë, jo të saktë dhe të shpërqendruar. Mundohuni të mos ndikoheni.

### GAFORJA
Jupiteri ju cakton pak energji dhe burime, pak mundësi konkurrence, pak mirëkuptim shoqëror dhe vështirësi në përmbylljen e kontratave. Me Marsin armiqësor, mund të keni tensione në çështje familjare, që nuk do të jenë shumë të lehta për t'u zgjidhur.

### LUANI
Të shpërblyer nga Venusi, Marsi dhe Urani krijimtaria e juaj do të jetë më shumë se kurrë e spikatur, qofshit apo jo artist. Do të jeni të suksesshëm në punë. Saturni vazhdon veprimtarinë e vet që ndikon pozitivisht tek ju. Autoritetin dhe besueshmërinë do të keni në ngritje

### VIRGJERESHA
Për shkak të Neptunit jo të favorshëm ndaj jush, nganjëherë kush ju qëndron pranë mund t'ju duket se ju kundërshton. Kërkoni një bisedë sqaruese. Ndërsa jeni nën ndikimin e Neptunit, mos e merrni çdo gjë për të mirëqenë.

### PESHORJA
Nëse jeni beqarë, Jupiteri mund t'ju ndihmojë të zgjeroni njohjet dhe të lindin histori të reja. Nëse keni një partner, çlironi pasionin. Me Uranin kundra, duhet të bëni kujdes në çështje dhe negociata që kanë të bëjnë me punën.

### AKREPI
Neptuni për ju luan një rol gjithmonë thelbësor dhe ju dhuron intuitën dhe aftësinë për t'u marrë vesh me të gjithë, edhe me heshtje. Mos merrni përsipër shumë angazhime që e dini se nuk keni mundësi t'i menaxhoni. Mësoni të thoni jo.

### SHIGJETARI
Me pozicionimin e Saturnit nuk duhet të ngadalësoni ritmin për të realizuar një projekt me sukses. Ndoshta do t'ju duhet një kohë e gjatë, por ç'rëndësi ka? Jeni në çift. Saturni do t'ju ndihmojë të stabilizoheni dhe të ndërmerrni rrugën e qëndrueshmërisë.

### BRICJAPI
Pozicioni negativ i Uranit mund t'ju shtyjë të merrni vendime të papritura dhe të bëni ndryshime të rastit. Pa u shqetësuar, jepini zgjidhje të prerë situatave të ndryshme. Nisur nga pozicioni i Marsit, bëni kujdes ndaj ndonjë shqetësimi të shkaktuar nga vrulli i tepërt.

### UJORI
Jupiteri ju sjell fatin në anën e juaj, dhe mbi të gjitha, do të bëjë që punët të mos ju marrin shumë kohë nga kënaqësia. Në punë parashikohen bashkëpunime të reja, projekte të reja dhe perspektiva të reja më fitimprurëse.

### PESHQIT
Nën ndikimin e Hënës që zihet me Saturnin, do të keni keqkuptime të mundshme në familje, e për rrjedhojë një ndjenjë fajësie për çdo gjë pa arsye. Klima e ftohtë ju bën të mbylleni në shtëpi, por angazhime të ndryshme ju shtrëngojnë të jeni në lëvizje.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al




**Tashmë edhe lundroni!**